L7WBE68SI

SQ **Udhëzimet për përdorim**
Pajisje për Larje-Tharje

USER MANUAL



AEG

PËRMBAJTJA

1. INFORMACIONI I SIGURISË..... 3
2. UDHËZIMET PËR SIGURINË..... 6
3. PËRSHKRIM I PRODUKTIT..... 8
4. TË DHËNA TEKNIKE..... 8
5. INSTALIMI..... 9
6. PANELI I KONTROLLIT..... 19
7. ÇELËSI PËRZGJEDHËS DHE BUTONAT..... 21
8. PROGRAMET..... 25
9. CILËSIMET..... 34
10. PËRPARA PËRDORIMIT TË PARË..... 35
11. PËRDORIMI I PËRDITSHËM - VETËM LARJE..... 35
12. PËRDORIMI I PËRDITSHËM - LARJE DHE THARJE..... 39
13. PËRDORIMI I PËRDITSHËM - VETËM THARJE..... 41
14. PUSH NË RROBA..... 42
15. UDHËZIME DHE KËSHILLA..... 43
16. KUJDESI DHE PASTRIMI..... 45
17. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE..... 52
18. VLERAT E KONSUMIT..... 56

PËR REZULTATE TË SHKËLQYERA

Faleminderit që zgjodhët këtë produkt AEG. Këtë produkt e kemi krijuar që të ketë performancë të përkryer për shumë vite, me teknologji inovative që e bëjnë jetën më të thjeshtë - karakteristika të cilat mund të mos i gjeni në pajisjet e zakonshme. Kushtojini disa minuta leximit të manualit për të marrë maksimumin nga ky produkt.
Vizitoni faqen tonë të internetit për:

Marrjen e këshillave të përdorimit, broshurave, informacionit për ndreqjen e problemeve, shërbimin dhe riparimin:
www.aeg.com/support

Regjistrimin e produktit tuaj për shërbim më të mirë:
www.registeraeg.com

Blerjen e aksesorëve, pjesëve të konsumueshme dhe pjesëve origjinale të këmbimit për pajisjen tuaj:
www.aeg.com/shop

KUJDESI DHE SHËRBIMI PËR KLIENTËT

Përdorni gjithmonë pjesë origjinale këmbimi.
Kur kontaktoni Qendrën tonë të Autorizuar të Shërbimit, sigurohuni që të dispononi të dhënat e mëposhtme: Modeli, PNC, numri serial.
Informacioni mund të gjendet në pllakën e specifikimeve.

⚠ Paralajmërim / Të dhëna për sigurinë dhe kujdesin

ⓘ Të dhëna të përgjithshme dhe këshilla

Të dhëna për ambientin

Rezervohet mundësia e ndryshimeve.

1. ⚠ INFORMACIONI I SIGURISË

Përpara instalimit dhe përdorimit të pajisjes, lexoni me kujdes udhëzimet e ofruara. Prodhuesi nuk është përgjegjës për lëndimet apo dëmet si rezultat i instalimit apo përdorimit të papërshtatshëm. Gjithmonë mbajini udhëzimet në një vend të sigurt dhe ku mund të arrihen lehtë për t'iu referuar në të ardhmen.

1.1 Siguria e fëmijëve dhe personave me probleme

⚠ **PARALAJMËRIM!**
Rrezik mbytjeje, plagosjeje ose gjymtimi të përhershëm.

- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e sipër dhe persona me aftësi të kufizuara fizike, ndijimesh ose mendore ose që nuk kanë eksperiencë dhe njohuri, nëse këta mbahen nën mbikëqyrje ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjes dhe i kuptojnë rreziqet e përdorimit.
- Fëmijët nga 3 deri në 8 vjeç dhe personat me aftësi të kufizuara shumë të theksuara dhe komplekse duhet të mbahen larg nga pajisja, përveçse kur mbahen nën monitorim të vazhdueshëm.
- Fëmijët nën 3 vjeç duhet të mbahen larg nga pajisja, përveçse kur mbikëqyren në mënyrë të vazhdueshme.
- Mos lejoni fëmijët të luajnë me pajisjen.
- Mbajeni të gjithë paketimin larg nga fëmijët dhe hidheni atë siç kërkohet.
- Mbajini detergjentet larg fëmijëve.
- Mbajini fëmijët dhe kafshët shtëpiake larg pajisjes, gjatë kohës që dera e saj është e hapur.
- Nëse pajisja ka një mekanizëm për sigurinë e fëmijëve, ai duhet aktivizuar.
- Fëmijët nuk duhet të kryejnë pastrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes pa mbikëqyrje.

1.2 Siguria e përgjithshme

- Mos i ndryshoni specifikimet e kësaj pajisjeje.
- Kjo pajisje është vetëm për përdorim në shtëpi dhe për përdorime të ngjashme, si p.sh.:
  - në zonat e kuzhinës për personelin në dyqane, në zyra dhe në ambiente të tjera pune;
  - nga klientët në hotele, motele, hotele me mëngjes dhe ambiente të tjera banimi;
  - në zonat për përdorim të përbashkët në blloqe apartamentesh ose në lavanderi.
- Pajisja duhet të instalohet më vete ose poshtë tavolinës së kuzhinës nëse e lejon hapësira.
- Mos e instaloni pajisjen pas një dere që kyçet, një dere rrëshqitëse apo një dere me menteshë në krahun e kundërt, e cila mund të pengojë hapjen e plotë të derës së pajisjes.
- Futeni spinën në prizë vetëm në fund të procesit të montimit. Sigurohuni që spina elektrike të jetë e arritshme mbas instalimit.
- Vrima e ajrimit në pjesën e poshtme nuk duhet të mbulohet nga tapeti, rrugica apo ndonjë mbulesë tjetër dyshemeje.
- KUJDES: Pajisja nuk duhet të furnizohet përmes një pajisjeje të jashtme ndezëse, si p.sh. kohëmatës, apo të lidhet me një qark që ndizet dhe fiket rregullisht nga një mjet.
- Siguroni ajrim të mirë të dhomës ku është instaluar pajisja për të shmangur rrjedhjen në dhomë të gazeve të padëshiruara që lëshojnë pajisjet që djegin gaz ose lëndë të tjera djegëse, duke përfshirë flakët e hapura.
- Ajri i shkarkimit nuk duhet të shkarkohet në një sistem aspirimi që përdoret për shkarkimin e tymrave nga pajisjet që djegin gaz ose lëndë të tjera djegëse.
- Presioni i punës i ujit në pikën e hyrjes së ujit nga lidhja e daljes duhet të jetë midis 0,5 bar (0,05 MPa) dhe 8 bar (0,8 MPa).

- Mos tejkaloni ngarkesën maksimale prej 8 kg (referojuni kapitullit "Tabela e programeve").
- Pajisja duhet të lidhet me furnizimin me ujë duke përdorur kompletin e ri të tubave që vjen me pajisjen ose komplete të tjera të reja tubash të ofruara nga qendra e autorizuar e shërbimit.
- Kompletet e vjetra të tubave nuk duhet të ripërdoren.
- Për të shmangur rreziqet elektrike, nëse kablloja elektrike është e dëmtuar, ajo duhet ndërruar nga prodhuesi, qendra e autorizuar e shërbimit ose persona me kualifikim të ngjashëm.
- Fshini pushin ose mbetjet e paketimit që janë grumbulluar përreth pajisjes.
- Artikujt e ndotur me substanca të tilla si vaj vegjetal ose mineral, aceton, alkool, benzinë, vajguri, heqës njollash, terpentinë, dyllë dhe heqës dylli duhet të lahen veçmas me një sasi shtesë detergjenti përpara se të thahen në makinën larëse dhe tharëse.
- Mos e përdorni pajisjen nëse artikujt janë të ndotur me kimikate industriale.
- Mos thani në tharëse rroba të palara.
- Artikujt e tillë si sfungjeri i gomuar (sfungjer lateks), skufjet e dushit, tekstilet rezistente ndaj ujit, artikujt me pjesë të gomuara dhe rrobat ose jastëkët me mbushje prej sfungjeri të gomuar nuk duhet të thahen në makinën larëse dhe tharëse.
- Zbutësit e rrobave ose produkte të ngjashme duhet të përdoren vetëm sipas specifikimeve të udhëzimeve të prodhuesit të produktit.
- Hiqni të gjitha objektet nga artikujt që mund të bëhen burim zjarri, të tillë si çakmakët apo shkrepëset.
- Mos e fikni asnjëherë makinën larëse dhe tharëse përpara përfundimit të ciklit të tharjes, nëse të gjithë artikujt nuk nxirren shpejt dhe nuk hapen në mënyrë që nxehtësia e mbetur të shpërndahet.
- Faza e fundit e ciklit të makinës larëse dhe tharëse kryhet pa nxehtësi (cikli i ftohjes) për të siguruar që artikujt të arrijnë një temperaturë që nuk i dëmton.

- Mos përdorni spërkatës me ujë me presion të lartë dhe/ose avull për të pastruar pajisjen.
- Pastrojeni pajisjen me një leckë të njomë. Përdorni vetëm detergjente neutrale. Mos përdorni produkte gërryese, materiale pastruese të ashpra, tretës ose objekte metalike.
- Përpara se të kryeni shërbim mirëmbajtjeje, çaktivizoni pajisjen dhe hiqni spinën nga priza.

2. UDHËZIMET PËR SIGURINË

2.1 Instalimi

Instalimi duhet të jetë në përputhje me rregulloret përkatës kombëtare.

- Ndiqni udhëzimet e instalimit të dhëna me pajisjen.
- Mos e përdorni pajisjen përpara se ta instaloni në strukturën inkaso për arsye sigurie.
- Mos e instaloni ose mos e përdorni pajisjen kur temperatura mund të jetë më e ulët se 0°C ose kur ekspozohet ndaj kushteve atmosferike.
- Gjithmonë mbajeni pajisjen vertikalisht kur e transportoni.
- Sigurohuni që ndërmjet pajisjes dhe dyshemesë të qarkullojë ajër.
- Hiqni paketimin dhe bulonat e transportit.
- Zona e dyshemesë ku do të instalohet pajisja duhet të jetë e sheshtë, e qëndrueshme, rezistente ndaj nxehtësisë dhe e pastër.
- Mbajini bulonat e transportit në një vend të sigurt. Nëse pajisja do të transportohet në të ardhmen, ata duhet të vendosen për të bllokuar kazanin për të parandaluar dëmtimet e brendshme.
- Gjithmonë bëni kujdes kur e lëvizni pajisjen sepse është e rëndë. Përdorni gjithnjë doreza sigurie dhe këpucë të mbyllura.
- Mos instaloni ose mos përdorni një pajisje të dëmtuar.
- Mos e instaloni pajisjen në një vend ku dera e pajisjes nuk mund të hapet plotësisht.
- Rregullojini këmbëzat në mënyrë që mes pajisjes dhe dyshemesë të ketë hapësirë të mjaftueshme.
- Pasi ta keni vendosur pajisjen në vendin e saj të përhershëm të punës, kontrolloni që të jetë saktësisht e niveluar me ndihmën e një niveluesi. Nëse jo, rregulloni këmbëzat siç duhet.

2.2 Lidhja elektrike

PARALAJMËRIM!
Rrezik zjarri dhe goditjeje elektrike.

- Pajisja duhet tokëzuar.
- Përdorni gjithmonë një prizë të tokëzuar të instaluar si duhet.
- Mos përdorni përshtatës me shumë spina dhe kabllo zgjatuese.
- Mos e shkëputni pajisjen nga rrjeti duke e tërhequr nga kablloja elektrike. Gjithmonë tërhiqeni kabllon elektrike duke e kapur nga spina.
- Mos e prekni kabllon elektrike ose spinën e rrymës me duar të lagura.

2.3 Lidhja e ujit

- Mos u shkaktoni dëmtim tubave të ujit.
- Përpara lidhjes me tuba të rinj, tubat që nuk janë përdorur për një kohë të gjatë, aty ku janë kryer punime riparimi ose janë vendosur pajisje të reja (sahate uji, etj.), lëreni ujin të rrjedhë derisa të jetë i kthjellët dhe i pastër.

- Sigurohuni që të mos ketë rrjedhje të dukshme uji gjatë dhe pas përdorimit të parë të pajisjes.

2.4 Përdorimi

PARALAJMËRIM!
Rrezik plagosjeje, goditjeje elektrike, zjarri, djegieje ose dëmtimi të pajisjes.

- Mos vendosni produkte të ndezshme ose sende të lagura me produkte të ndezshme brenda, pranë ose mbi pajisje.
- Mos e prekni xhamin e derës gjatë kohës që pajisja është në punë e sipër. Xhami mund të nxehet.
- Mos thani artikuj të dëmtuar (të grisur, të çarë) që përmbajnë material mbushës.
- Nëse rrobat janë larë me një heqës njollash, kryeni një cikël shtesë shpëlarjeje përpara se të filloni një cikël tharjeje.
- Sigurohuni që të keni hequr të gjitha objektet metalike nga rrobat.
- Thani vetëm rroba që janë të përshtatshme për tharjen në pajisje. Ndiqni udhëzimet e pastrimit në etiketën e artikujve.
- Mos u ulni dhe mos peshoni mbi derën e hapur të pajisjes.
- Mos thani në pajisje rroba të lagura që pikojnë ujë.
- Mos lejoni që enë të nxehta të prekin pjesët plastike të pajisjes.
- Hiqeni topin me detergjent (nëse përdoret) përpara se të filloni programin e tharjes.
- Mos përdorni top me detergjent nëse vendosni një program pa ndalim.

2.5 Ndriçimi i brendshëm

PARALAJMËRIM!
Rrezik plagosjeje.

- Në lidhje me llambat brenda produktit dhe llambat e pjesëve të këmbimit të shitura veçmas: Këto llamba janë prodhuar për kushte ekstreme fizike në pajisjet elektroshtëpiake, si p.sh. temperaturë, dridhje, lagështirë, ose janë prodhuar për të sinjalizuar informacion rreth statusit të përdorimit të pajisjes. Ato nuk janë prodhuar për t'u përdorur në aplikacione të tjera dhe nuk janë të përshtatshme për ndriçim në ambiente shtëpiake.
- Për të zëvendësuar dritën e brendshme, lidhuni me qendrën e autorizuar të shërbimit.

2.6 Servisi

- Për të riparuar pajisjen kontaktoni me qendrën të autorizuar të shërbimit. Përdorni vetëm pjesë këmbimi origjinale.
- Ju lutemi vini re se vetëriparimi ose riparimi joprofesional mund të ketë pasoja sigurie dhe mund të zhvlerësojë garancinë.
- Pjesët e mëposhtme të këmbimit do të jenë të disponueshme për 10 vjet pas daljes nga qarkullimi të modelit: motori dhe karbonçinat e motorit, transmisioni mes motorit dhe kazanit, amortizatorët dhe sustat, kazani i larjes, grupi i pasmë i kazanit dhe kushinetat përkatëse, ngrohësit dhe elementet e ngrohjes, duke përfshirë pompat e nxehtësisë, tubacionet dhe pajisjet përkatëse duke përfshirë zorrët, valvulat, filtrat dhe bllokuesit e ujit, qarqet elektrike, ekranet elektrike, çelësat e presionit, termostatet dhe sensorët, softuerët dhe firmuerët duke përfshirë softuerin e rivendosjes, derën, menteshën dhe guarnicionet e derës, guarnicionet e tjera, grupin e kyçjes së derës, mjetet periferike plastike si p.sh. foletë e detergjentit. Ju lutemi vini re se disa nga këto pjesë këmbimi janë të disponueshme vetëm për riparuesit profesionistë, dhe se jo të gjitha pjesët e këmbimit u përshtaten të gjitha modeleve.

2.7 Eliminimi i pajisjes

- Shkëputeni pajisjen nga rrjeti i furnizimit me energji dhe ai me ujë.
- Priteni kabllon e rrjetit elektrik pranë pajisjes dhe hidheni atë.
- Hiqni kapësen e derës për të parandaluar ngecjen e fëmijëve dhe të kafshëve shtëpiake brenda kazanit.
- Hidheni pajisjen në përputhje me kërkesat lokale për hedhjen e pajisjeve mbeturina elektrike dhe elektronike (WEEE).

3. PËRSHKRIM I PRODUKTIT

3.1 Pamje e përgjithshme e pajisjes



1. Suportet e menteshave
2. Foleja e detergjentit
3. Paneli i kontrollit
4. Pllaka magnetike
5. Doreza e derës
6. Etiketa e specifikimeve
7. Pllaka me rrahëse gome
8. Filtri i pompës së shkarkimit
9. Këmbët e përparme për nivelimin e pajisjes
10. Zorra e shkarkimit
11. Kablloja e furnizimit me energji
12. Lidhja e zorrës së hyrjes së ujit
13. Këmbët e pasme për nivelimin e pajisjes



Pllakëza e specifikimeve tregon emrin e modelit (**A**), numrin e produktit (**B**), parametrat elektrikë (**C**) dhe numrin e serisë (**D**).

4. TË DHËNA TEKNIKE

Përmasat	Gjerësia / Lartësia / Thellësia totale	59.6 cm /81.9 cm /55.3 cm
Lidhja elektrike	Tensioni	230 V
	Fuqia totale	2000 W
	Siguresa	10 A
	Frekuenca	50 Hz

Niveli i mbrojtjes ndaj hyrjes së grimcave të ngurta dhe lagështisë sigurohet nga kapaku mbrojtës, përveç rastit kur pajisja me tension të ulët nuk ka mbrojtje kundër lagështisë		IPX4
Furnizimi me ujë [1)]		Ujë i ftohtë
Presioni i furnizimit me ujë	Minimumi Maksimumi	0,5 bar (0,05 MPa) 8 bar (0,8 MPa)
Ngarkesa maksimale e larjes	Cotton (Të pambukta)	8 kg
Ngarkesa maksimale e tharjes	Të pambukta Sintetike	4 kg 3 kg
Shpejtësia e centrifugimit	Shpejtësia maksimale e rrotullimit	1551 rpm

1) Lidheni zorrën e hyrjes së ujit me një rubinet me filetim 3/4" .

5. INSTALIMI

PARALAJMËRIM!
Referojuni kapitujve për sigurinë.

5.1 Përgatituni për instalimin

Rekomandohet që instalimi të kryhet nga dy persona.



5.2 Pajisja është e pajisur me ...



5.3 Heqja e paketimit

PARALAJMËRIM!
Përdorni doreza.

PARALAJMËRIM!
Hiqni të gjithë ambalazhin dhe bulonat e transportit përpara se të instaloni pajisjen.



1. Vendoseni dy elementet paketuese prej polistireni mbi dysheme poshtë pajisjes.

PARALAJMËRIM!
Rekomandohet shumë që ky veprim të kryhet nga dy persona.

2. Uleni me kujdes pajisjen nga pjesa e pasme.

Sigurohuni që të mos dëmtoni zorrët.



3. Hiqni mbrojtësen prej polistireni nga pjesa e poshtme.



4. Kthejeni pajisjen në pozicion vertikal dhe hiqni mbrojtjen prej polistireni të prizës.



5. Hiqni kabllon e furnizimit me energji dhe zorrën e shkarkimit nga mbajtëset e zorrës.

Ka mundësi të shihni të derdhet ujë nga zorra e shkarkimit. Kjo ndodh për shkak të testimit të pajisjes me ujë në fabrikën e prodhimit.



6. Hiqni tre bulonat, mbajtëset e zorrës dhe distancatorët plastikë duke përdorur çelësin e dhënë me pajisjen.



7. Mbyllni vrimat me tapat plastike që do të gjeni në qesen e manualit të përdorimit. Vendosni tapën më të vogël **F** në vrimën e sipërme dhe dy tapat më të mëdha **G** në vrimat e poshtme.

Rekomandojmë që të mbani të gjithë ambalazhin dhe bulonat e transportit për çdo rast kur ju duhet ta zhvendosni pajisjen.

5.4 Pozicionimi dhe nivelimi



1. Instalojeni pajisjen mbi një dysheme të fortë e të sheshtë.

PARALAJMËRIM!
Sigurohuni që tapetet të mos pengojnë qarkullimin e ajrit poshtë pajisjes.

Silleni pajisen pranë zgavrës së mobilies përpara se ta niveloni atë. Për më shumë detaje, referojuni paragrafit "Montimi inkaso".

2. Lironi ose shtrëngoni këmbëzat për të rregulluar nivelin.

Rregullimi i duhur i nivelit të pajisjes parandalon dridhjet, zhurmat dhe lëvizjen e pajisjes kur është në punë.



Pajisja duhet të jetë e niveluar dhe e palëvizshme.

KUJDES!
Mos vendosni karton, dru apo materiale të tjera poshtë këmbëzave të pajisjes për të rregulluar nivelin.

5.5 Lidhja e zorrës dhe e kabllove



Zorra e furnizimit me ujë



1.Hiqni zorrën e hyrjes së ujit nga brenda kazanit.
2. Për të lidhur zorrën e hyrjes së ujit drejt drejtimit të duhur dhe me animin e duhur, kontrolloni pozicionin e rubinetit të ujit përpara se ta lidhni me pjesën e pasme të pajisjes.

Sigurohuni që zorra të mos jetë as e përthyer ose e shtypur, por as e tendosur.



3. Lidhni zorrën me pjesën e pasme të pajisjes. Mos e rrotulloni zorrën e hyrjes poshtë, por rrotullojeni majtas apo djathtas në varësi të pozicionit të rubinetin tuaj të ujit.
4. Lironi vidën unazë për ta fiksuar në pozicionin e duhur.



5. Lidheni zorrën e furnizimit me ujë te një rubinet uji me fileto 3/4.

PARALAJMËRIM!
Sigurohuni që të mos ketë rrjedhje nga pjesët bashkuese.

Përdorni zorrën e dhënë bashkë me pajisjen.

Mos përdorni zorrë zgjatuese nëse zorra e furnizimit me ujë është tepër e shkurtër. Kontaktoni me qendrën e shërbimit për zëvendësimin e zorrës së furnizimit të ujit.

Shkarkimi i ujit

Tubi i shkarkimit mund të lidhet:



Me një tub me një vrimë ventilimi
Direkt në tubin e shkarkimit në një lartësi jo më të vogël se 60 cm (23.6”) dhe jo më të madhe se 100 cm (39.3”).
Gryka e tubit të shkarkimit duhet të ajroset gjithmonë, pra diametri i brendshëm i tubit të shkarkimit (min. 40 mm - min. 1,6”) duhet të jetë më i madh se diametri i jashtëm i tubit të shkarkimit.



Në një spigotë shkarkimi lavamani
Vendoseni tubin e shkarkimit në spigotë dhe shtrëngojeni me lidhësen e dhënë të kabllos **L**.
Sigurohuni që tubi i shkarkimit të krijojë një hark për të parandaluar që copëzat të futen në pajisje nga lavamani.



Në një tub në mur
Direkt në një tub shkarkimi të futur në murin e dhomës dhe të shtrënguar me lidhësen e dhënë të kabllos **L**.

Ju mund ta zgjasni tubin e shkarkimit maksimumi 400 cm. Kontaktoni me qendrën e shërbimit për tub tjetër dhe për zgjatues.

5.6 Montimi inkaso



Kjo pajisje është bërë për t’u ndërfutur me mobiliet e kuzhinës. Shikoni dimensionet minimale të zgavrës në skica.



Nëse zorrët kalojnë prapa pajisjes, sigurohuni që të mos ketë asgjë që mbyll zgavrën e vogël të treguar me përmasat 50 x 50 mm.



Pajisja është e pajisur gjithashtu me një sfungjer adeziv **H** që mund ta gjeni brenda kazanit.
Vendoseni atë në krye të pajisjes ku tregohet në skicë.
Kur niveloni pajisjen poshtë mobilies, MOS e shtypni sfungjerin.



Përpara se të vazhdoni me inkasimin e pajisjes, silleni atë pranë zgavrës dhe poziciononi paraprakisht zorrën e hyrjes, zorrën e shkarkimit dhe kabllot kryesore.

PARALAJMËRIM!
Sigurohuni që të mos jenë përthyer ose shtypur.

5.7 Përgatitja dhe montimi i derës së dollapit

Përmasat e derës së dollapit duhet të jenë:
- gjerësia min. 595 - maks. 598 mm;
- trashësia 16-22 mm.



Cilësimi i fabrikës
Pajisja është parapërgatitur si fillim për montimin e derës së dollapit me hapje nga e djathta në të majtë.

Zgjidhja më e mirë do të ishte vidhosja e menteshës së sipërme me vrimën e sipërme të pllakës së sipërme dhe menteshës së poshtme me vrimën e poshtme të pllakës së poshtme.



Ndryshimi i drejtimit të derës së dollapit
Kryejeni kthimin e drejtimit të derës së dollapit përpara se pajisja të inkasohet plotësisht.



Nëse dera duhet të hapet nga e majta në të djathtë, ktheni pozicionin e suporteve të menteshave **M** me pllakën magnetike **N** dhe pllakën e poshtme **O**.



Sigurohuni që pllaka me magnetin të jetë në pozicionin e sipërm.





Përgatitja e derës së dollapit

Për vendosjen e derës rrafsh, rekomandohet që të kërkoni ndihmën e një profesionisti.

Bashkërenditeni saktësisht derën e dollapit me mobilien.
Matni distancën **X** për të rregulluar lartësinë e vrimës për të bërë rrafsh menteshën e sipërme. Qendra e vrimës **Y** duhet të jetë në të njëjtën lartësi me kalimin në suportin e menteshës.
Vendoseni pozicionin e vrimës së poshtme duke respektuar dimensionet dhe distancat e treguara në skicë (449 mm).
Rrafshoni vrimat.



Menteshat
Për të montuar menteshat është e domosdoshme të hapen dy vrima (dia. 35 mm, thellësia 12,5 - 14 mm në varësi të thellësisë së derës së dollapit) në anën e brendshme të derës.
Menteshat do të fiksohen në derë përmes katër vidave të dhëna **A**.



Për ta bashkërenditur derën në mënyrë të përkryer, sigurohuni që ana e derës së dollapit të jetë paralele me anën e pajisjes dhe të respektojë këndin e duhur të hapjes (maks. 105 °).





Montimi i derës
Fiksoni menteshat me suportet e menteshave në pajisje përmes dy vidave të dhëna **B**.

Menteshat mund të përshtaten për të kompensuar mospërputhjet në trashësinë e derës.

Kundër-magneti
Pajisja është parapërgatitur për një mbyllje magnetike.
Për mbylljen e duhur:
1. Pozicionojeni vidën **C** dhe kundër-magnetin **D** në pllakën magnetike **N**. Anojeni derën e dollapit kundrejt vidës derisa të lërë një shenjë.
2. Hapni derën e dollapit dhe vidhosni kundër-magnetin **D** (disku i çelikut + unaza prej gome **E**) me vidën **C** në anën e brendshme të derës së dollapit, ku vida ka lënë shenjën e përshkruar në hapin e parë.

5.8 Lidhja elektrike

Në fund të instalimit mund të futni në prizë spinën e pajisjes.

Pllakëza e specifikimeve dhe kapitulli “Të dhënat teknike” tregojnë parametrat e nevojshëm elektrikë. Sigurohuni që të jenë në pajtim me furnizimin kryesor me energji.

Kontrolloni që instalimet elektrike të shtëpisë tuaj mund të durojnë ngarkesën maksimale e parashikuar, duke patur parasysh edhe pajisje të tjera shtëpiake në përdorim

Lidheni pajisjen në një prizë me tokëzim.



Kablloja e lidhjes me rrjetin duhet të jetë lehtësisht e arritshme pas instalimit të pajisjes.

Për punimet elektrike që nevojiten për instalimin e kësaj pajisjeje, kontaktoni me Qendrën tonë të Autorizuar të Shërbimit.

Prodhuesi nuk mban asnjë përgjegjësi për dëmtime ose lëndime të shkaktuara si pasojë e mosndjekjes së udhëzimeve të mësipërme të sigurisë.

6. PANELI I KONTROLLIT

6.1 Përshkrimi i panelit të kontrollit



Opsionet e përhershme vendosen duke mbajtur shtypur butonin përkatës për të paktën 3 sekonda.

1. Çelësi i programeve
2. Centrifugim butoni me prekje
3. Temperatura butoni me prekje
4. Ekrani
5. Koha butoni me prekje
6. Tharje butoni me prekje
7. Start/Pause butoni me prekje
8. Vonesë në nisje butoni me prekje
9. Butoni me prekje Regjimi - Tharje dhe opsioni i Antirrudhës së përhershme 3s
10. Butoni me prekje Kursimi i kohës dhe opsioni i Bllokimit për fëmijët 3s
11. Butoni me prekje Njolla dhe opsioni Soft Plus 3s
12. Butoni me prekje Paralarje dhe opsioni Shpëlarje shtesë 3s
13. On/Off butoni me shtypje
14. Larja butoni me prekje

6.2 Ekrani



88°	Zona e temperaturës: 88 Treguesi i temperaturës. _ _ * Treguesi i ujit të ftohtë.
	Treguesi i derës së bllokuar.
	Treguesi i bllokimit të sigurisë për fëmijët.
0:00	Treguesi dixhital mund të tregojë: • Kohëzgjatja e programit (p.sh. 2:40, faza e larjes dhe/ose tharjes). • Koha e vonesës (p.sh. 2h). • Përfundimi i ciklit (0:00). • Kodi i paralajmërimit (p.sh. E20). • Treguesi i gabimit (– – –).
_____	Kursimi i kohës treguesi.
	Koha treguesi.
	Treguesi i fazës me avull.
	Tharje treguesi: Tharje për hekurosje Tharje për në dollap Tharje shtesë
	Treguesi i fazës së larjes
	Treguesi i Shpëlarjes shtesë.

	E butë Plus treguesi.
	Treguesi i pastrimit të kazanit. Ky është rekomandim për të kryer një pastrim të kazanit. Referojuni paragrafit “Pastrimi i kazanit” në kapitullin “Kujdesi dhe pastrimi”.
	Treguesi i fazës kundër rrudhave.
	Treguesi i fazës së tharjes.
	Zona e centrifugimit: Treguesi i shpejtësisë së centrifugimit **– – –** Treguesi Pa centrifugim. Faza e centrifugimit është çaktivizuar.
	Treguesi i ndërprerjes së shpëlarjes.
	Treguesi i peshës maksimale (referojuni paragrafit “Zbulimi i ngarkesës së ProSense System”). **MAX** Ai pulson kur ngarkesa e rrobave tejkalon ngarkesën maksimale të deklaruar të programit të përzgjedhur.
	Treguesi i shtimit të rrobave. Ndizet në fillim të fazës së larjes, kur është ende e mundshme që pajisja të vendoset në pauzë dhe të shtohen më shumë rroba.

7. ÇELËSI PËRZGJEDHËS DHE BUTONAT

7.1 Hyrje

Opsionet/funksionet nuk janë të disponueshme për gjithë programet e larjes. Kontrolloni përputhshmërinë midis opsioneve/funksioneve dhe programeve të larjes në "Tabelën e programeve". Një opsion/funksion mund të përjashtojë një tjetër, në këtë rast pajisja nuk ju lejon të vendosni opsione/funksione të papajtueshme.

7.2 On/Off

Shtypni këtë buton për pak sekonda për të aktivizuar ose çaktivizuar pajisjen. Dëgjohen dy tinguj të ndryshëm gjatë ndezjes ose fikjes së pajisjes.

Ndërsa funksion i Pritjes aktive e çaktivizon automatikisht pajisjen pas disa minutash për të ulur konsumin e energjisë, mund t'ju nevojitet ta aktivizoni sërish pajisjen.

Për më shumë detaje, referojuni paragrafit "Pritja aktive" në kapitullin "Përdorimi i përditshëm".

7.3 Temperatura

Kur përzgjidhni një program larjeje, pajisja propozon automatikisht një temperaturë të parazgjedhur.

Prekeni këtë buton në mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet vlera e dëshiruar e temperaturës në ekran.

Kur ekrani shfaq treguesit – – *, pajisja nuk e ngroh ujin.

7.4 Centrifugim

Kur vendosni një program, pajisja vendos automatikisht shpejtësinë maksimale të lejuar të centrifugimit përveç programit Denim. Me këtë opsion

ju mund të ulni shpejtësinë e parazgjedhur të centrifugimit.

Prekeni këtë buton në mënyrë të përsëritur që të:

- **Ulni shpejtësinë e centrifugimit.** Ekrani tregon vetëm shpejtësitë e disponueshme të centrifugimit për programin e vendosur.
- Opsionet shtesë të centrifugimi **Pa centrifugim – – –**.
  Vendosni këtë opsion për të çaktivizuar të gjitha fazat e centrifugimit. Pajisja kryen vetëm fazën e shkarkimit të programit të zgjedhur të larjes. Vendosni këtë opsion për pëlhura shumë delikate. Faza e shpëlarjes përdor më shumë ujë për disa programe larjeje
- Aktivizoni funksionin **Ndërprerje e shpëlarjes**.
  Nuk është kryer centrifugimi i fundit. Uji i shpëlarjes së fundit nuk do të shkarkohet për të evituar zhubrosjen e rrobave. Programi i larjes përfundon me ujë në kazan.

  Treguesi ndizet. Dera qëndron e kyçur dhe kazani rrotullohet rregullisht për të reduktuar rrudhosjen. Për të zhbllokuar derën duhet të shkarkoni ujin.

  Nëse prekni butonin Start/Pause, pajisja kryen një fazë centrifugimi dhe shkarkon ujin.

Pajisja e zbraz ujin automatikisht pas afro 18 orësh.

7.5 Larja

Ky buton ju lejon të aktivizoni ose çaktivizoni regjimin e larjes. Treguesi i butonit ndizet kur regjimi i larjes aktivizohet.

7.6 Paralarje

Me këtë opsion mund të shtoni një fazë paralarjeje te një program larjeje.

Treguesi korrespondues mbi butonin me prekje ndizet.

- Përdoreni këtë funksion për të shtuar një fazë paralarjeje në 30 °C përpara fazës së larjes.

  Ky opsion rekomandohet për rrobat e ndotura shumë, veçanërisht nëse përmbajnë rërë, pluhur, baltë dhe grimca të tjera të ngurta.

Opsionet mund të rrisin kohëzgjatjen e programit.

7.7 Shpëlarja e përhershme shtesë 3s

Me këtë funksion mund të keni në mënyrë të përhershme një shpëlarje shtesë kur vendosni një program të ri.

Për ta **aktivizuar/çaktivizuar** këtë opsion, prekni butonin Paralarje për 3 sekonda derisa treguesi **të ndizet/të fiket** në ekran.

Kur aktivizohet, pajisja do të kalojë si parazgjedhje në këtë opsion pasi ta fikni ose të ndryshoni/rivendosni programin.

Ky opsion rrit kohëzgjatjen e programit.

7.8 Njolla

Prekeni këtë buton për të shtuar fazën e njollave në një program.

Treguesi korrespondues mbi butonin me prekje ndizet.

Përdoreni këtë opsion për rroba që kanë njolla të vështira për t'u hequr.

Kur vendosni këtë opsion, hidhni heqësin e njollave në ndarje.

Ky opsion rrit kohëzgjatjen e programit.
Ky opsion nuk është i disponueshëm me një temperaturë më të ulët se 40°C.

7.9 E përhershme E butë Plus 3s

Vendosni këtë opsion për të optimizuar shpërndarjen e zbutësit të rrobave dhe për të përmirësuar butësinë e rrobave.

Rekomandohet kur përdorni zbutësin e rrobave.

Për të **aktivizuar/çaktivizuar** këtë opsion, mbani shtypur butonin Njolla për 3 sekonda derisa treguesi **të ndizet/fiket** në ekran.

Kur aktivizohet, pajisja do të kalojë si parazgjedhje në këtë opsion pasi ta fikni ose të ndryshoni/rivendosni programin.

Ky opsion rrit kohëzgjatjen e programit.

7.10 Kursimi i kohës

Me këtë opsion mund të reduktoni kohëzgjatjen e programit në varësi të madhësisë së ngarkesës dhe nivelit të ndotjes.

Kur vendos një program larjeje, ekrani tregon kohëzgjatjen e parazgjedhur dhe ––––– vija.

Prekni butonin Kursimi i kohës për të reduktuar kohëzgjatjen e programit sipas nevojave tuaja. Ekrani shfaq kohëzgjatjen e re të programit dhe një numër vijëzash do të ulen përkatësisht:

––––– e përshtatshme për një ngarkesë të plotë me rroba me ndotje normale.

––– një cikël i shpejtë për një ngarkesë të plotë me rroba me ndotje të vogël.

–– cikël shumë i shpejtë për ngarkesë me ndotje shumë të vogël (rekomandohet maks. një gjysmë ngarkese).

– cikli më i shkurtër për të freskuar një sasi të vogël rrobash.

Opsioni Kursimi i kohës është i disponueshëm vetëm me programet në tabelë.

treguesi	Eco 40-60	Pambuk	Sintetike
––––– 1)	■	■	■
––––	■	■	■
–––	■	■	■
––	■	■	■
–	■	■	■

1) Kohëzgjatja e parazgjedhur për të gjitha programet.

Kursimi i kohës e programet e avullit

Kur vendosni një program me avull, ky buton ju lejon të zgjidhni tri nivele avulli dhe kohëzgjatja e programit reduktohet përkatësisht:

- ––– : maksimumi.
- –– : mesatare.
- – : minimumi.

7.11 Bllokimi për fëmijët 3s

Me këtë opsion mund të parandaloni që fëmijët të luajnë me panelin e kontrollit.

Për ta **aktivizuar/çaktivizuar** këtë opsion, prekni butonin Kursimi i kohës derisa treguesi **të ndizet/të fiket** në ekran.

Kur aktivizohet, pajisja do të kalojë si parazgjedhje në këtë opsion pasi ta fikni ose të ndryshoni/rivendosni programin.

Nëse shtypni një buton, treguesi pulson për të treguar se butonat janë çaktivizuar.

7.12 Regjimi - Tharje

Ky buton ju lejon të aktivizoni ose çaktivizoni regjimin e tharjes. Treguesi i butonit ndizet kur regjimi i tharjes aktivizohet.

7.13 Antirrudhë e përhershme
3s

Ky opsion shton një fazë të shkurtër kundër rrudhave në fund të programit.

Kjo fazë redukton rrudhat e rrobave dhe lehtëson hekurosjen e tyre.

Për ta **aktivizuar/çaktivizuar** këtë opsion, prekni butonin Regjimi - Tharje për 3 sekonda derisa treguesi **të ndizet/të fiket** në ekran.

Kur aktivizohet, pajisja do të kalojë si parazgjedhje në këtë opsion pasi ta fikni ose të ndryshoni/rivendosni programin.

Ky opsion mund të rrisë pak kohëzgjatjen e programit.

7.14 Tharje

Prekni këtë buton për të vendosur një nga nivelet e tharjes automatike që mundëson pajisja.

Në ekran, ndizet treguesi përkatës i tharjes:

- **Tharje për hekurosje**: rrobat që duhet të hekurosen.
- **Tharje për dollap**: rrobat që duhet të futen në dollap.
- **Tharje ekstra**: rrobat që duhet të thahen plotësisht.

Nuk mund të vendosni të gjitha nivelet automatike për secilin lloj tekstili.

7.15 Koha

Prekni këtë buton për të vendosur kohën e duhur sipas tekstileve që do të lani (referojuni tabelës "Tharja e programuar"). Në ekran shfaqet vlera e vendosur.

Sa herë që të prekni këtë buton, koha rritet me 5 minuta.

Ju nuk mund t'i vendosni të gjithë vlerat e kohës për lloje të ndryshme materialesh.

7.16 Vonesë në nisje

Me këtë opsion mund ta shtyni fillimin e programit deri në një kohë më të të volitshme.

Prekni në mënyrë të përsëritur butonin për të vendosur shtyrjen e kërkuar. Koha rritet me hapa prej 1 ore deri në 20 orësh.

Treguesi korrespondues mbi butonin me prekje ndizet.

Në ekran shfaqet koha e zgjedhur e shtyrjes. Pasi prekni butonin Start/Pause pajisja fillon numërimin mbrapsht dhe dera bllokohet.

7.17 Start/Pause

Shtypni butonin Start/Pause për të filluar, vendosur në pauzë ose ndërprerë një program që është në punë.

8. PROGRAMET

8.1 Tabela e programeve

Programi Temperatura e parazgjedhur Gama e temperaturës	Shpejtësia referencë e centrifugimit Gama e shpejtësisë së centrifugimit	Ngarkesa maksimale	Përshkrimi i pajisjes (Lloji i ngarkesës dhe niveli i ndotjes)
Eco 40-60 (Regjimi vetëm larje) 40 °C[1)] 60 °C[2)] - 30 °C	1600 rpm 1600 rpm - 400 rpm	8 kg	**Të pambuktat e bardha dhe me ngjyra që nuk zbehen**. Artikujt me ndotje normale.
Eco 40-60 + Niveli i tharjes për dollap (regjimi Larje dhe tharje) 40 °C[3)] 60 °C - 30 °C	1600 rpm 1600 rpm - 400 rpm	4 kg	
Eco 40-60 + Niveli i tharjes për dollap (regjimi Vetëm tharje)[4)]		4 kg	**Të pambuktat e bardha dhe me ngjyra që nuk zbehen**.
Pambuk 40 °C 90 °C - I ftohtë	1600 rpm (1600- 400 rpm)	8 kg	**Të pambuktat e bardha dhe me ngjyra**. Artikuj me ndotje normale, të madhe dhe të lehtë.
Sintetike 40 °C 60 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200 - 400 rpm)	3 kg	**Artikuj sintetikë ose artikuj prej materialesh të përziera**. Artikujt me ndotje normale.

Programi Temperatura e parazgjedhur Gama e temperaturës	Shpejtësia referencë e centrifugimit Gama e shpejtësisë së centrifugimit	Ngarkesa maksimale	Përshkrimi i pajisjes (Lloji i ngarkesës dhe niveli i ndotjes)
Delikat 30 °C 40 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200- 400 rpm)	2 kg	**Tekstile delikate të tilla si akrilike, viskoze dhe tekstile të përziera kërkojnë larje më delikate**. Artikuj me ndotje normale dhe të lehtë.
Të leshta/Larje me dorë 40 °C 40 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200 - 400 rpm)	1,5 kg	**Të leshta që lahen në makinë larëse, të leshta që lahen me dorë dhe tekstile të tjera** me simbolin e kujdesit “larje me dorë”[5].

Programi i avullit

Programi me avull mund të përdoret për reduktimin e rrudhave dhe aromave[6] të rrobave që kanë nevojë vetëm për freskim, shmangni larjen. Fibrat e rrobave relaksohen dhe më pas hekurosja bëhet dhe plotësisht e lehtë. Kur përfundon programi, hiqni me shpejtësi rrobat nga kazani[7]. Programet me avull nuk kryejnë cikël higjienizues. Mos e vendosni këtë program me llojet e mëposhtme të rrobave:

- Artikujt që nuk janë të përshtatshëm për tharjen në tharëse.
- Artikujt me etiketën “Vetëm për pastrim kimik”.

Avull	-	1 kg	**Pambuk, Sintetike, Delikate.** Program i shkurtër dhe delikat me avull për të freskuar edhe rrobat më delikate, duke përfshirë rroba shumë delikate me temina, dantella etj. Kur trajtoni ngarkesa më të vogla, kohëzgjatja e programit mund të reduktohet më tej përmes opsionit Kursimi i kohës. **PARALAJMËRIM!** Mos e përdorni këtë program me rroba të leshta dhe me etiketën vetëm për pastrim kimik.
Centrifugim/ Shkarkim	1600 rpm (1600 - 400 rpm)	8 kg	**Të gjitha tekstilet, përveç të leshtave dhe tekstileve shumë delikate**. Për të centrifuguar rrobat dhe për të shkarkuar ujin në kazan.

Programi Temperatura e parazgjedhur Gama e temperaturës	Shpejtësia referencë e centrifugimit Gama e shpejtësisë së centrifugimit	Ngarkesa maksimale	Përshkrimi i pajisjes (Lloji i ngarkesës dhe niveli i ndotjes)
Shpëlarje	1600 rpm (1600- 400 rpm)	8 kg	**Të gjitha tekstilet, përveç të leshtave dhe tekstileve shumë delikate.** Program për të shpëlarë dhe për të centrifuguar rrobat. Shpejtësia e parazgjedhur e centrifugimit është ajo që përdoret për programet e pambukut. Reduktojeni shpejtësinë e centrifugimit sipas llojit të rrobave. Nëse është e nevojshme, caktoni opsionin Shpëlarje shtesë për të shtuar shpëlarje. Me një shpejtësi të ulët centrifugimi, pajisja kryen shpëlarje delikate dhe centrifugim të shkurtër.
Pastrimi i pajisjes 60 °C	1200 rpm (1200 - 400 rpm)	-	Cikël mirëmbajtjeje me ujë të nxehtë për të pastruar dhe freskuar kazanin, si dhe për tërhequr mbetjet që mund të shkaktojnë aroma të këqija. Për rezultate optimale përdoreni këtë cikël një herë në muaj. Përpara përdorimit të këtij cikli, hiqni të gjitha artikujt nga kazani. Në ndarjen e fazës së larjes të kutisë së detergjentit, vendoseni fletën e ndarjes në pozicionin lart. Derdhni një kupë zbardhues ose pastrues lavatriçeje në ndarjen e fazës së larjes. **MOS** i përdorni të dyja së bashku. Pas pastrimit të kazanit, vendosni një cikël tjetër shpëlarjeje me kazan bosh dhe pa detergjent për të hequr mbetjet e zbardhuesit. Nëse e vendosni këtë program me Regjimi - Tharje, pajisja kryen veprimin kundër pushit. Referojuni kapitullit “Push në rroba”.
Antialergjik 60 °C	1600 rpm (1600 - 400 rpm)	8 kg	**Artikuj të bardhë të pambuktë**. Ky program largon mikroorganizmat falë një faze larjeje me temperaturë që mbahet mbi 60°C për disa minuta. Kjo ndihmon në heqjen e mikrobeve, baktereve, mikro-organizmave dhe grimcave. Një fazë tjetër shpëlarjeje siguron heqjen e duhur të mbetjeve të detergjentit dhe polenit/substancave alergjike. Në këtë mënyrë, larja është më efikase.

Programi Temperatura e parazgjedhur Gama e temperaturës	Shpejtësia referencë e centrifugimit Gama e shpejtësisë së centrifugimit	Ngarkesa maksimale	Përshkrimi i pajisjes (Lloji i ngarkesës dhe niveli i ndotjes)
Veshje sportive 30 °C 40 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200- 400 rpm)	3 kg	**Artikuj sportivë sintetikë**. Ky program është projektuar për të larë butësisht rrobat moderne sportive që përdoren jashtë dhe është gjithashtu i përshtatshëm për rrobat e palestrës, çiklizmit apo vrapimit ose artikuj të ngjashëm.
Outdoor 30 °C 40 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200- 400 rpm)	2 kg	Mos përdorni zbutës rrobash dhe sigurohuni që kenë mbetur mbetje zbutësi në folenë e detergjentit. **Rroba që vishen jashtë, rroba pune, sportive, xhaketa të papërshkueshme nga uji, xhupa me shtresë të heqshme me push ose me izolim të brendshëm**. Duke kryer një program larjeje dhe tharjeje të kombinuar, faza e tharjes vepron gjithashtu si restaurues i papërshkueshmërisë së ujit. **Sigurohuni që etiketa e kujdesit të veshjes të lejojë tharjen me tharëse.**
Denim 30 °C 40 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200 - 400 rpm)	3 kg	**Program special për xhinse me fazë delikate larjeje për të minimizuar zbehjen e ngjyrave dhe shenjat**. Për kujdes më të mirë, rekomandohet një ngarkesë e reduktuar.
NonStop 60min 30 °C 40 °C - 30 °C	1200 rpm	1 kg	**Tekstilet e përziera (të pambukta dhe sintetike)**. Program i plotë i shkurtër për të larë dhe për të tharë rroba me ngarkesë deri në 1 kg njëherësh. Zgjat vetëm 1 orë.

Programi Temperatura e parazgjedhur Gama e temperaturës	Shpejtësia referencë e centrifugimit Gama e shpejtësisë së centrifugimit	Ngarkesa maksimale	Përshkrimi i pajisjes (Lloji i ngarkesës dhe niveli i ndotjes)
•	Rivendosni pozicionin. Ekrani shfaq vetëm vija.		

1) **Sipas Rregullores 2019/2023 të Komisionit të BE-së.** Ky program në temperaturë dhe shpejtësi centrifugimi të parazgjedhur, vetëm në regjimin e larjes, me kapacitet nominal prej 8 kg mund të pastrojë rrobat prej pambuku me ndotje normale të deklaruara për larje në 40 °C ose 60 °C, së bashku në të njëjtin cikël.

Për temperaturën e arritur në rroba, kohëzgjatjen e programit dhe të dhënat e tjera, ju lutemi shikoni kapitullin “Vlerat e konsumimit”.
Programet më efikase në lidhje me konsumin e energjisë janë në përgjithësi ato që performojnë në temperatura më të ulëta dhe kohëzgjatje më të gjata.

2) **Programi me kursim energjie për të pambukta**. Ky program në 60°C me ngarkesë 8 kg është programi të cilit i referohen të dhënat në etiketën e energjisë, në pajtim me Direktivën 96/60/EC. Caktoni këtë program për të pasur rezultate të mira në larje dhe për të ulur konsumin e energjisë. Koha e programit të larjes është zgjatur.

3) **Sipas Rregullores 2019/2023 të Komisionit të BE-së.** Ky program në temperaturë dhe shpejtësi centrifugimi të parazgjedhur, në regjimin e larjes dhe tharjes, me kapacitet nominal prej 4 kg dhe me nivelin e Tharjes për dollap kryen ciklin e larjes dhe tharjes që mund të pastrojë rroba prej pambuku me ndotje normale të deklaruara për larje në 40 °C ose 60 °C, së bashku në të njëjtin cikël, dhe pas fazës së tharjes, rrobat mund të ruhen menjëherë në dollap.

4) Ky program është programi referencë i tharjes për të dhënat në etiketën e energjisë, në pajtim me Direktivën 96/60/EC. Performanca e testit, në përputhje me EN 50229, duhet të kryhet me ngarkesën E PARË të tharjes me kapacitetin maksimal të deklaruar të tharjes (përbërja e ngarkesës sipas EN 61121) duke caktuar programin THARJE AUTOMATIKE PËR DOLLAP për programin Eco 40-60. Ngarkesa E DYTË e tharjes me ngarkesën e mbetur duhet të testohet duke caktuar programin THARJE AUTOMATIKE PËR DOLLAP për programin Eco 40-60.

5) Gjatë këtij cikli kazani rrotullohet ngadalë për të garantuar larje delikate. Mund të duket që kazani nuk rrotullohet fare ose nuk rrotullohet mirë, por është normale për këtë program.

6) Programi me avull nuk e heq aromën shumë të fortë.

7) Pas trajtimit me avull, rrobat mund të jenë të njoma. Varini rrobat jashtë për pak minuta.

Përshtatshmëria e opsioneve të programit

Programi	Centrifugim	Pa centrifugim	[1]	Paralarje[2]	3s	Njolla	3s	Kursimi i kohës	3s	Vonesë në nisje
Eco 40-60	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
Pambuk	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
Sintetike	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
Delikat	■	■	■		■		■		■	■
Të leshta/Larje me dorë	■	■	■							■
Avull								■		■
Centrifugim/ Shkarkim	■	■[3]								■
Shpëlarje	■	■	■		■				■	■
Pastrimi i pajisjes	■	■								■
Antialergjik	■	■	■	■	■	■	■		■	■
Veshje sportive	■	■	■	■	■				■	■
Outdoor	■	■	■		■				■	■
Denim	■	■	■		■	■	■		■	■

Programi	Centrifugim	Pa centrifugim	[1]	Paralarje[2]	3s	Njolla	3s	Kursimi i kohës	3s	Vonesë në nisje
NonStop 60min									■	■

1) Ky opsion përjashton opsionin 3s.

2) Paralarje dhe Njolla nuk mund të zgjidhen së bashku.

3) Nëse caktoni opsionin Pa centrifugim, pajisja vetëm kryen shkarkimin.

Detergjentet e përshtatshme për secilin program

Programi	Pluhur universal[1]	Lëng universal	Lëng për rroba me ngjyra	Delikate të leshta	I veçantë
Eco 40-60	▲	▲	▲	--	--
Pambuk	▲	▲	▲	--	--
Sintetike	▲	▲	▲	--	--
Delikat	--	--	--	▲	▲
Të leshta/ Larje me dorë	--	--	--	▲	▲
Antialergjik	▲	▲	--	--	▲
Veshje sportive	--	▲	▲	--	▲
Outdoor	--	--	--	▲	▲
Denim	--	--	▲	▲	▲
NonStop 60min	--	▲	▲	--	--

1) Në temperaturë më të lartë se 60 °C rekomandohet përdorimi i detergjentit pluhur.

▲ = Rekomandohet

-- = Nuk rekomandohet

8.2 Woolmark Apparel Care - Blu

- Cikli i larjes për të leshtat në këtë pajisje është miratuar nga “The Woolmark Company” për larjen e rrobave të leshta që mbajnë etiketën “për larje me dorë” nëse rrobat lahen sipas udhëzimeve të dhëna nga prodhuesi i kësaj lavatriçeje. Ndiqni udhëzimet e tharjes dhe proceseve të tjera të larjes në etiketën për kujdesin ndaj rrobave. M1380
- Cikli i tharjes për të leshtat në këtë lavatriçe është miratuar nga “The Woolmark Company” për tharjen e rrobave të leshta që mbajnë etiketën “për larje me dorë” nëse rrobat thahen sipas udhëzimeve të prodhuesit të kësaj makinerie. Ndiqni etiketën e kujdesit për rrobat për udhëzime të tjera rreth tyre. M1381

Simboli “Woolmark” është markë certifikimi në shumë vende.

8.3 Tharje automatike

Niveli i tharjes	Lloji i tekstilit	Ngarkesa
☀ **Tharje ekstra** Për materialet prej peshqiri	**Të pambukta dhe tekstile prej linoje** (rrobat e banjës, peshqirët, etj)	deri në 4 kg
	Veshjet e xhinsit	deri në 3 kg

Niveli i tharjes	Lloji i tekstilit	Ngarkesa
☼ **Tharje për dollap** Për rrobat që vihen në dollap	**Të pambukta dhe tekstile prej linoje** (rrobat e banjës, peshqirët, etj)	deri në 4 kg
	Materiale sintetike ose të përziera (trikot, bluzat, të brendshmet, shtrojat dhe çarçafët)	deri në 3 kg
	Tekstile delikate (tekstile akrilike, viskoze dhe tekstile delikate të përziera)	deri në 2 kg
	Artikuj prej leshi (triko të leshta)	deri në 1 kg
	Rroba sportive që vishen jashtë (rroba që vishen jashtë, rroba pune, sportive, xhaketa të papërshkueshme nga uji, xhupa me push)	deri në 2 kg
	Veshjet e xhinsit	deri në 3 kg
	Veshje sportive	deri në 3 kg
☼ **Tharje për hekurosje** E përshtatshme për hekurosje	**Të pambukta dhe tekstile prej linoje** (çarçafë, mbulesat e tavolinës, këmisha, etj)	deri në 4 kg

8.4 Tharja e programuar

Niveli i tharjes	Lloji i tekstilit	Ngarkesa (kg)	Shpejtësia e centrifugimit (rpm)	Kohëzgjatja e rekomanduar (min)
Tharje ekstra Për materialet prej peshqiri	**Të pambukta dhe tekstile prej linoje** (rrobat e banjës, peshqirët, etj)	4	1600	170 - 190
		2	1600	110 - 120
		1	1600	65 - 75
	Veshjet e xhinsit	3	1200	165 - 175
		1	1200	75 - 85

Niveli i tharjes	Lloji i tekstilit	Ngarkesa (kg)	Shpejtësia e centrifugimit (rpm)	Kohëzgjatja e rekomanduar (min)
Tharje për dollap Për rrobat që vihen në dollap	**Të pambukta dhe tekstile prej linoje** (rrobat e banjës, peshqirët, etj)	4	1600	160 - 180
		2	1600	100 - 110
		1	1600	55 - 65
	Materiale sintetike ose të përziera (trikot, bluzat, të brendshmet, shtrojat dhe çarçafët)	3	1200	135 - 150
		1	1200	45 - 55
	Delikate (tekstile akrilike, viskoze dhe tekstile delikate të përziera)	2	1200	155 - 165
		1	1200	95 - 105
	Lesh (triko të leshta)	1	1200	80 - 100
	Rroba sportive që vishen jashtë (rroba që vishen jashtë, rroba pune, sportive, xhaketa të papërshkueshme nga uji, xhupa me push)	2	1200	110 - 120
		1	1200	95 - 105
	Veshjet e xhinsit	3	1200	155 - 165
		1	1200	65 - 75
	Veshje sportive	3	1200	130 - 150
		1	1200	70 - 80
Tharje për hekurosje E përshtatshme për hekurosje	**Të pambukta dhe tekstile prej linoje** (çarçafë, mbulesat e tavolinës, këmisha, etj)	4	1600	110 - 125
		2	1600	65 - 75
		1	1600	40 - 50

9. CILËSIMET

9.1 Sinjalet akustike

Kjo pajisje ka sinjale të ndryshme akustike, që veprojnë kur:

- Aktivizoni pajisjen (sinjal i shkurtër i veçantë).
- Çaktivizoni pajisjen (sinjal i shkurtër i veçantë).
- Prekni butonat (tingull klikimi).
- Bëni përzgjedhjen e gabuar (3 tinguj të shkurtër).
- Programi përfundon (sekuencë tingujsh për rreth 2 minuta).
- Programi ka keqfunksionim (sekuencë tingujsh të shkurtër për rreth 5 minuta).

Për të **aktivizuar/çaktivizuar** sinjalet akustike kur përfundon programi, prekni njëkohësisht butonat dhe për rreth 2 sekonda. Në ekran shfaqet Ndezje ose Fikje.

Nëse çaktivizoni sinjalet akustike, ato vazhdojnë të punojnë kur pajisja ka keqfunksionim.

10. PËRPARA PËRDORIMIT TË PARË

1. Sigurohuni që të disponohet energjia elektrike dhe që rubineti i ujit të jetë i hapur.
2. Derdhni 2 litra ujë në folenë e detergjentit të shënuar me II.

Ky veprim aktivizon sistemin e shkarkimit.

3. Derdhni një sasi të vogël detergjenti në folenë e detergjentit të shënuar me II.
4. Vendosni dhe startoni një program për të pambuktat në temperaturën më të lartë pa rroba në kazan.

Kjo do të heqë të gjitha papastërtitë e mundshme nga tamburi dhe kazani.

11. PËRDORIMI I PËRDITSHËM - VETËM LARJE

PARALAJMËRIM!
Referojuni kapitujve për sigurinë.

11.1 Aktivizimi i pajisjes

1. Futeni spinën në prizën elektrike.
2. Hapeni rubinetin e ujit.
3. Shtypni butonin On/Off për pak sekonda për të aktivizuar pajisjen.

Bie një tingull i shkurtër.

11.2 Futja e rrobave në pajisje

1. Hapni derën e pajisjes.
2. Zbrazni xhepat dhe shpalosni rrobat artikujt përpara se t'i vendosni ato brenda pajisjes.
3. Vendosini artikujt në kazan, njërin pas tjetrit.

Mos fusni shumë rroba në kazan.

4. Mbylleni derën mirë.



KUJDES!
Sigurohuni që të mos ngecin rroba mes guarnicionit dhe derës për të shmangur rrezikun e rrjedhjes së ujit dhe dëmtimit të rrobave.

Larja e njollave tepër të ndotura me vaj dhe graso mund të dëmtojë pjesët prej gome të lavatriçes.

11.3 Mbushja me detergjente dhe produkte suplementare



I - Ndarja për fazën e paralarjes, programin e njomjes ose heqjen e njollave.

II - Ndarja për fazën e larjes.

❀ - Ndarja e zbutësit të rrobave dhe trajtimeve të tjera me lëngje (solucion rrobash, niseshte).
MAX - Niveli maksimal i sasisë së aditivëve të lëngshëm.
⛆ - Ndarësja për detergjentin pluhur ose të lëngshëm.

Gjithmonë zbatoni udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i produkteve të detergjentit, por rekomandojmë që të mos tejkaloni nivelin maksimal të treguar (**MAX**). Kjo sasi garanton rezultatet më të mira në larje.

Pas një cikli larjeje, nëse është e nevojshme, hiqni mbetjet e detergjentit nga foleja e detergjentit.

11.4 Kontrolloni pozicionin e ndarëses të detergjentit

1. Tërhiqeni jashtë kutinë e detergjentit derisa të ndalojë.



2. Shtypeni levën për poshtë për ta hequr kutinë.
3. Për të përdorur detergjent pluhur, ktheni ndarësen për lart.
4. Për të përdorur detergjent të lëngshëm, ktheni ndarësen për poshtë.



Me ndarësen në pozicionin **POSHTË**:
- Mos përdorni detergjent xhelatinoz ose detergjente me lëng të trashë.
- Mos e tejkaloni dozën e detergjentit të lëngshëm që tregohet në ndarje.
- Mos e vendosni fazën e paralarjes.
- Mos e vendosni funksionin e shtyrjes së programit.

5. Matni sasinë e duhur të detergjentit dhe të zbutësit të rrobave.
6. Mbylleni me kujdes kutinë e detergjentit.



Sigurohuni që ndarësja të mos krijojë bllokim kur të mbyllni sirtarin.

11.5 Vendosja e një programi

1. Rrotulloni çelësin e programeve për të zgjedhur programin e dëshiruar të larjes.

Treguesi i butonit Larja ndizet.

Treguesi i butonit Start/Pause ▷‖ pulson.

Ekrani tregon kohëzgjatjen e përafërt të programit dhe ngarkesën maksimale.

2. Prekni butonat përkatës për të ndryshuar temperaturën dhe/ose shpejtësinë e centrifugimit.

3. Nëse dëshironi, vendosni një ose më shumë opsione duke prekur butonat përkatës. Treguesit përkatës ndizen në ekran dhe informacioni i dhënë ndryshon përkatësisht.

Nëse **nuk është e mundur** përzgjedhja, bie një sinjal akustik dhe ekrani tregon – – –.

11.6 Nisja e një programi

Prekni butonin Start/Pause ▷‖ për të filluar programin. Programi nuk mund të niset kur treguesi i butonit është i çaktivizuar dhe nuk pulson (p.sh. dera është e hapur).
Treguesi përkatës ndalon së pulsuari dhe qëndron i ndezur.
Programi fillon, dera është e bllokuar.

Ekrani shfaq treguesin 🔒.

Pompa e shkarkimit mund të punojë pak përpara se pajisja të mbushet me ujë.

11.7 Nisja e një programi me shtyrje programi

1. Prekni butonin Vonesë në nisje ⏲ në mënyrë të përsëritur derisa ekrani të shfaqë kohën e dëshiruar të vonesës. Treguesi përkatës ndizet.
2. Prekni butonin Start/Pause ▷‖. Dera e pajisjes kyçet dhe fillon numërimin mbrapsht të shtyrjes së programit.

   Ekrani shfaq treguesin 🔒.

Kur të përfundojë numërimi mbrapsht, programi fillon automatikisht.

Anulimi i shtyrjes së programit pasi ka nisur numërimi mbrapsht

Për të anuluar shtyrjen e programit:

1. Shtypni butonin Start/Pause ▷‖ për ta vënë pajisjen në pauzë. Treguesi përkatës pulson.
2. Prekni butonin Vonesë në nisje ⏲ në mënyrë të përsëritur derisa ekrani të tregojë 🔓.
3. Shtypni sërish butonin Start/Pause ▷‖ për ta filluar programin menjëherë.

Ndryshimi i shtyrjes së programit pasi ka nisur numërimi mbrapsht

Për të ndryshuar shtyrjen e programit:

1. Shtypni butonin Start/Pause ▷‖ për ta vënë pajisjen në pauzë. Treguesi përkatës pulson.
2. Prekni butonin Vonesë në nisje ⏲ në mënyrë të përsëritur derisa ekrani të shfaqë kohën e dëshiruar të vonesës.
3. Shtypni sërish butonin Start/Pause ▷‖ për ta filluar numërimin e ri mbrapsht.

11.8 Dallimi i ngarkesës me ProSense System

Kohëzgjatja e programit në ekran i referohet një **ngarkese të mesme/të lartë**.

Pas prekjes së butonit Start/Pause ▷‖, çaktivizohet treguesi i ngarkesës maksimale të deklaruar, ProSense System fillon dallimin e ngarkesës së rrobave:

1. Pajisja e dallon ngarkesën brenda 30 sekondave të para. Në programet ku disponohet Kursimi i kohës, gjatë kësaj faze shiritat Kursimi i kohës ---- të vendosur poshtë shifrave të kohës, luajnë një animacion të thjeshtë. Kazani rrotullohet shkurtimisht.
2. Kohëzgjatja e programit mund të rregullohet përkatësisht dhe mund të rritet ose ulet. Pas 30 sekondave të tjera, fillon mbushja me ujë.

Në përfundim të dallimit të ngarkesës, **në rast mbingarkese të kazanit**, treguesi **MAX** pulson në ekran:

Në këtë rast, për 30 sekonda, pajisja mund të vendoset në pauzë dhe mund të hiqen rrobat e tepërta.

Pasi hiqen rrobat e tepërta, prekni butonin Start/Pause ▷‖ për të nisur sërish programin. Faza ProSense mund të përsëritet deri në tre herë (shikoni pikën 1).

E rëndësishme! Nëse nuk do të reduktohet sasia e rrobave, programi i larjes fillon gjithsesi, pavarësisht mbingarkesës. Në këtë rast, nuk do të jetë e mundur që të garantohen rezultatet më të mira të larjes.

Pas 20 minutash pas nisjes së programit, kohëzgjatja e programit mund të përshtatet sërish në varësi të kapacitetit të thithjes së ujit nga rrobat.

Dallimi me ProSense kryhet vetëm me programet e plota të larjes dhe nëse kohëzgjatja e programit nuk është reduktuar përmes butonit Kursimi i kohës.

11.9 Ndërprerja e programit dhe ndryshimi i opsioneve

Kur programi është në punë, mund të ndryshoni **vetëm disa** opsione:

1. Prekni butonin Start/Pause ▷‖.

Treguesi përkatës pulson.

2. Ndrysho opsionet. Informacioni i dhënë në ekran ndryshon përkatësisht.
3. Prekni sërish butonin Start/Pause ▷‖.

Programi i larjes vazhdon.

11.10 Anulimi i një programi në funksionim

1. Shtypni butonin On/Off për të anuluar programin dhe për të çaktivizuar pajisjen.
2. Shtypni sërish butonin On/Off për të riaktivizuar pajisjen.

Nëse ProSense System ka përfunduar dhe ka filluar tashmë mbushja me ujë, programi i ri fillon **pa përsëritur ProSense System**. Uji dhe detergjenti nuk shkarkohen për të shmangur shpenzimet. Ekrani shfaq kohëzgjatjen maksimale të programit, duke e përditësuar atë rreth 20 minuta pas nisjes së programit të ri.

Ekziston edhe një mënyrë alternative për anulimin:

1. Rrotullojeni çelësin përzgjedhës në pozicionin "Reset" (Rivendos) •.
2. Pritni për 1 sekondë. Ekrani shfaq ---.

Tani, ju mund të vendosni një program të ri larjeje.

11.11 Hapja e derës - Shtimi i rrobave

Nëse temperatura dhe niveli i ujit në kazan janë shumë të larta dhe/ose kazani vazhdon të rrotullohet, ju nuk duhet ta hapni derën.

Kur një program ose shtyrje programi është në punë, dera e pajisjes është e kyçur. Ekrani shfaq treguesin ⊸□.

1. Prekni butonin Start/Pause ▷‖.

Në ekran fiket treguesi përkatës i bllokimit të derës.

2. Hapni derën e pajisjes. Nëse është e nevojshme, shtoni ose hiqni artikujt. Mbyllni derën dhe prekni butonin Start/Pause ▷‖.

Vazhdon programi ose shtyrja e programit.

11.12 Përfundimi i programit

Kur programi të ketë përfunduar, pajisja fiket automatikisht. Sinjalet akustike funksionojnë, (nëse janë aktive). Ekrani shfaq 0:00

Treguesi i butonit Start/Pause ▷‖ fiket.

Dera zhbllokohet dhe treguesi fiket.

1. Shtypni butonin e On/Off për të çaktivizuar pajisjen.

Pesë minuta pas përfundimit të programit, funksioni i kursimit të energjisë e çaktivizon automatikisht pajisjen.

Kur e aktivizoni pajisjen përsëri, ekrani tregon fundin e programit të mëparshëm. Rrotullojeni çelësin e programeve për të vendosur një cikël të ri.

2. Nxirrni nga pajisja rrobat.
3. Sigurohuni që kazani të jetë bosh.
4. Mbajeni derën dhe folenë e detergjentit paksa të hapur, për të parandaluar mykun dhe erërat e pakëndshme.

11.13 Shkarkimi i ujit pas përfundimit të ciklit

Nëse keni zgjedhur një program ose një opsion që nuk e zbraz ujin e shpëlarjes së fundit, programi përfundon, por:

- Zona e kohës shfaq 0:00 dhe ekrani shfaq derën e kyçur.
- Treguesi i butonit Start/Pause fillon të pulsojë.
- Kazani vazhdon të rrotullohet me intervale të rregullta për të parandaluar rrudhat te rrobat.
- Dera qëndron e bllokuar.
- Për të hapur derën duhet të shkarkoni ujin:

1. Nëse është e nevojshme, prekni butonin Centrifugim për të ulur shpejtësinë e centrifugimit të propozuar nga pajisja.
2. Shtypni butoninStart/Pause: pajisja shkarkon ujin dhe kryen centrifugimin.

Treguesi i opsionit të Ndërprerjes së shpëlarjes zhduket.

Nëse keni vendosur Pa centrifugim – – –, pajisja do të shkarkojë vetëm ujin.

3. Kur programi të ketë përfunduar dhe treguesi i bllokimit të derës të fiket, ju mund ta hapni derën.
4. Shtypni butonin On/Off për pak sekonda për të çaktivizuar pajisjen.

11.14 Funksioni i gatishmërisë

Funksioni i gatishmërisë çaktivizon automatikisht pajisjen për të ulur konsumimin e energjisë kur:

- Nuk e përdorni pajisjen për 5 minuta kur nuk ka program në punë. Shtypni butonin On/Off për ta aktivizuar pajisjen sërish.
- 5 minuta pas përfundimit të programit të larjes. Shtypni butonin On/Off për ta aktivizuar pajisjen sërish. Ekrani tregon përfundimin e programit të fundit. Rrotullojeni çelësin e programeve për të vendosur një cikël të ri.

Nëse çelësi rrotullohet në pozicionin "Reset" (Rivendosja) , pajisja fiket automatikisht pas 30 sekondash.

Nëse vendosni një program ose opsion që përfundon me ujë në kazan, funksioni i gatishmërisë **nuk çaktivizon** pajisjen për t'ju kujtuar të shkarkoni ujin.

12. PËRDORIMI I PËRDITSHËM - LARJE DHE THARJE

PARALAJMËRIM!
Referojuni kapitujve për sigurinë.

Kjo pajisje është lavatriçe automatike me tharje.

12.1 Programi i plotë larjeje dhe tharjeje

Programi ose programet automatike Non-Stop

Në varësi të modelit, pajisja mund të jetë e pajisur me një ose më shumë programe NonStop 60min programe automatike të larjes dhe tharjes ku nuk është nevoja të caktoni Regjimi - Tharje.

Veproni si më poshtë:

1. Pas ngarkimit të rrobave dhe detergjentit, shtypni butonin On/Off për disa sekonda për të aktivizuar pajisjen.
2. Vendosni programin NonStop 60min duke përdorur çelësin e programeve. Treguesit dhe shfaqen në ekran.
3. Prekni butonin Start/Pause për të nisur programin.

Programet joautomatike të larjes dhe tharjes

Në disa programe larjeje, mund të kombinoni Larja dhe Regjimi - Tharje për të vënë në punë një program të plotë larjeje dhe tharjeje.

Veproni si më poshtë:

1. Shtypni butonin On/Off për disa sekonda për të aktivizuar pajisjen.
2. Ngarkoni rrobat njëra pas tjetrës.
3. Vendosni detergjentin dhe produktet suplementare në ndarjen e duhur.
4. Rrotulloni çelësin e zgjedhjes te programi i larjes. Pajisja kalon në regjimin vetëm larje dhe ndizet treguesi i butonit Larja është i ndezur. Në ekran shfaqet temperatura e parazgjedhur dhe centrifugimi. Nëse nevojitet, ndryshojini ato sipas llojit të rrobave. Ekrani shfaq gjithashtu ngarkesën maksimale të rekomanduar për fazën e larjes.
5. Vendosni opsionet e dëshiruara, nëse janë të disponueshme.
6. Trokitni mbi butonin Regjimi - Tharje për të aktivizuar edhe funksionin e tharjes. Të dy treguesit e butonave Larja dhe Regjimi - Tharje janë të ndezur. Treguesit dhe shfaqen në ekran. Ekrani tregon gjithashtu ngarkesën maksimale të rekomanduar për një program larjeje dhe tharjeje (p.sh. 4 kg për të pambuktat).

12.2 Larja dhe tharja - Nivelet automatike

1. Trokitni butonin Tharje në mënyrë të përsëritur derisa ekrani të shfaqë nivelin e kërkuar të tharjes. Treguesit mbi ekran japin ndriçimet përkatëse:
   a. **Tharje për hekurosje**: për artikujt e pambuktë;
   b. **Tharje për dollap**: për artikujt e pambuktë dhe sintetikë;
   c. **Ekstra**: për artikujt e pambuktë.

Vlera e kohës në ekran është kohëzgjatja e cikleve të larjes dhe tharjes, llogaritur në madhësinë e paracaktuar të ngarkesës.

Për të pasur një tharje të mirë duke përdorur më pak energji dhe brenda një kohe më të shkurtër, pajisja nuk ju lejon të vendosni shpejtësi centrifugimi shumë të ulët për rrobat që do të lahen e thahen.

2. Prekni butonin Start/Pause për të nisur programin. Fillon llogaritja e ProSense.

Në ekran ndizet treguesi i derës së kyçur .

Në ekran shfaqet gjithashtu koha e mbetur e programit.

12.3 Larje dhe tharje me kohë të caktuar

1. Trokitni butonin Koha vazhdimisht për të vendosur vlerën e dëshiruar të kohës (shikoni tabelën “Programi i tharjes” te kapitulli “Programet”).
   Niveli i treguesit të tharjes fiket dhe ndizet treguesi .

Sa herë që të trokitni mbi këtë buton, koha rritet me 5 minuta. Në ekran shfaqet vlera e re e vendosur e kohës.

2. Prekni butonin Start/Pause ▷‖ për të nisur programin. Fillon llogaritja e ProSense.

Në ekran ndizet treguesi i derës së kyçur 🔒.

Në ekran shfaqet gjithashtu koha e mbetur e programit.

12.4 Në fund të programit të tharjes

- Pajisja ndalon automatikisht.
- Sinjalet akustike funksionojnë, (nëse janë aktive).
- Në ekran ndizet 0:00.
- Treguesi i butonit Start/Pause ▷‖ fiket. Simboli i bllokimit të derës 🔒 fiket.
  Pajisja vazhdon të punojë me fazën kundër rrudhave për rreth 30 minuta të tjera ose më shumë nëse është vendosur opsioni Antirrudhë.
  Faza kundër rrudhave redukton rrudhat.
  Mund t'i hiqni rrobat përpara përfundimit të fazës kundër rrudhave. Për rezultate më të mira, rekomandojmë t'i hiqni rrobat kur faza të ketë përfunduar ose pothuajse të ketë përfunduar. Treguesi 👕 mbetet i ndezur.
- Shtypni butonin On/Off për disa sekonda për të çaktivizuar pajisjen.

ⓘ Disa minuta pas përfundimit të programit, funksioni i kursimit të energjisë e çaktivizon automatikisht pajisjen.

1. Nxirrni nga pajisja rrobat.
2. Sigurohuni që kazani të jetë bosh.

ⓘ Pas fazës së tharjes, pastroni kazanin, guarnicionin dhe pjesën e brendshme të derës me një leckë të lagur.

13. PËRDORIMI I PËRDITSHËM - VETËM THARJE

⚠ **PARALAJMËRIM!**
Referojuni kapitujve për sigurinë.

ⓘ Kjo pajisje është lavatriçe automatike me tharje.

13.1 Përgatitja për tharje

1. Shtypni butonin On/Off për disa sekonda për të aktivizuar pajisjen.
2. Ngarkoni rrobat njëra pas tjetrës.
3. Rrotulloni çelësin e programit te programi e përshtatshëm për tharjen e artikujve. Pajisja kalon në regjimin vetëm larje dhe ndizet treguesi i butonit Larja.
4. Trokitni mbi butonin Regjimi - Tharje dhe më pas mbi butonin Larja për të kryer vetëm tharje. Treguesi i butonit Regjimi - Tharje ndizet dhe treguesi i butonit Larja fiket. Treguesit ≋ dhe ☼ shfaqen në ekran dhe zhduket treguesi ≋.

ⓘ Kur thani një sasi të madhe rrobash, për të pasur një performancë tharjeje të mirë sigurohuni që rrobat nuk janë mbështjellë me njëra-tjetrën dhe që janë të shpërndara në mënyrë uniforme në kazan.

13.2 Tharja - Nivelet automatike

1. Trokitni mbi butonin Tharje ≋ AUTO vazhdimisht derisa ekrani të tregojë nivelin e kërkuar të tharjes. Treguesit mbi ekran japin ndriçimet përkatëse:
   a. ☼ **Tharje për hekurosje**: për artikujt e pambuktë;
   b. ☼ **Tharje për dollap**: për artikujt e pambuktë dhe sintetikë;
   c. ☼ **Tharje ekstra**: për artikujt e pambuktë.

Ekrani tregon kohëzgjatjen e programit të tharjes.

2. Prekni butonin Start/Pause ▷‖ për të filluar programin.

Në ekran ndizet treguesi i derës së kyçur ⊸▯.

Në ekran shfaqet gjithashtu koha e mbetur e programit.

13.3 Tharja e programuar

1. Trokit butonin Koha ⏲ vazhdimisht për të vendosur vlerën e dëshiruar të kohës (shiko tabelën "Programi i tharjes" te kapitulli "Programet").

   Treguesi i nivelit të tharjes ☼ fiket dhe ndizet treguesi ⏲.

Sa herë që të trokitni mbi këtë buton, koha rritet me 5 minuta. Në ekran shfaqet vlera e re e vendosur e kohës.

2. Prekni Start/Pause ▷‖ për të filluar programin.

Në ekran ndizet treguesi i derës së kyçur ⊸▯.

Në ekran shfaqet gjithashtu koha e mbetur e programit.

13.4 Në fund të programit të tharjes

- Pajisja ndalon automatikisht.
- Sinjalet akustike funksionojnë, (nëse janë aktive).
- Në ekran ndizet 0:00.
- Treguesi i butonit Start/Pause ▷‖ fiket. Simboli i bllokimit të derës ⊸▯ fiket.
  Pajisja vazhdon të punojë me fazën kundër rrudhave për rreth 30 minuta të tjera ose më shumë nëse është vendosur opsioni Antirrudhë.
  Faza kundër rrudhave redukton rrudhat.
  Mund t'i hiqni rrobat përpara përfundimit të fazës kundër rrudhave. Për rezultate më të mira, rekomandojmë t'i hiqni rrobat kur faza të ketë përfunduar ose pothuajse të ketë përfunduar. Treguesi 👕 mbetet i ndezur.
- Shtypni butonin On/Off për disa sekonda për të çaktivizuar pajisjen.

ⓘ Disa minuta pas përfundimit të programit, funksioni i kursimit të energjisë e çaktivizon automatikisht pajisjen.

1. Nxirrni nga pajisja rrobat.
2. Sigurohuni që kazani të jetë bosh.

ⓘ Pas fazës së tharjes, pastroni kazanin, guarnicionin dhe pjesën e brendshme të derës me një leckë të lagur.

14. PUSH NË RROBA

Gjatë fazës së larjes dhe/ose tharjes, disa lloje tekstilesh, (prej sfungjeri, leshi, tekstilet e trikove) mund të lëshojnë push.

Pushi i lëshuar mund të ngjitet me rrobat gjatë ciklit tjetër të larjes.

Ky disavantazh rritet me tekstilet industriale.

Për të parandaluar pushin në rrobat tuaja, ju rekomandojmë që:

- Të mos lani tekstilet e errëta pasi të lahen dhe thahen tekstile me ngjyra të çelura (peshqirë duarsh, lesh, pulovra pambuku) dhe anasjelltas.
- Të thani në ajër këto lloje tekstilesh kur lahen për herë të parë.
- Të pastroni filtrin e shkarkimit.
- Pas fazës së tharjes, pastroni kazanin bosh, guarnicionin dhe derën me një leckë të lagur.

Për të hequr pushin brenda kazanit, vendosni një program të veçantë:

- Zbrazni kazanin.
- Pastroni kazanin, guarnicionin dhe derën me një leckë të lagur.
- Vendosni programin Pastrimi i pajisjes dhe Regjimi - Tharje ⧚ së bashku për të aktivizuar veprimin kundër pushit.
- Prekni butonin Start/Pause ▷‖ për të filluar programin.

Nëse pajisja përdoret shpesh, kryeni rregullisht programin e pastrimit.

15. UDHËZIME DHE KËSHILLA

PARALAJMËRIM!
Referojuni kapitujve për sigurinë.

15.1 Ngarkesa e rrobave

- Ndajini rrobat në: të bardha, me ngjyra, sintetike, delikate dhe të leshta.
- Zbatoni udhëzimet e larjes në etiketat e kujdesit te rrobat.
- Mos lani së bashku rrobat e bardha dhe ato me ngjyrë.
- Disa rroba me ngjyra mund të zbehen gjatë larjes së parë. Rekomandojmë që t'i lani ato veçmas dy-tri herët e para.
- Kthejini së prapthi rrobat me disa shtresa, të leshtat dhe veshjet me stampa.
- Trajtoni paraprakisht njollat e vështira.
- Lajini njollat e vështira me detergjent të veçantë.
- Bëni kujdes me perdet. Hiqini kapëset e tyre dhe futini perdet në një qese për larje apo këllëf jastëku.
- Një ngarkesë shumë e vogël mund të shkaktojë probleme balancimi gjatë fazës së centrifugimit duke çuar në dridhje të tepërta. Nëse ndodh kjo:
  a. ndërprisni programin dhe hapni derën (referojuni kapitullit "Përdorimi i përditshëm");
  b. rishpërndajeni me dorë ngarkesën në mënyrë që rrobat të shpërndahen njëtrajtësisht nëpër kazan;
  c. shtypni butonin Start/Pause. Faza e centrifugimit vazhdon.
- Kopsitni këllëfët e jastëkëve, mbyllni zinxhirët, tokëzat dhe sustat. Lidhni rripat, kordonët, lidhëset e këpucëve, fjongot dhe çdo element tjetër të lirshëm.
- Mos lani rroba pa tegela ose me prerje. Përdorni një trastë larjeje për të larë rroba të vogla dhe/ose delikate (p.sh. sytjena me tela, rripa, streçe, lidhëse këpucësh, fjongo etj.).



- Zbrazni xhepat dhe shpalosni rrobat.



15.2 Njollat e vështira

Për disa njolla, nuk mjafton uji dhe detergjenti.

Rekomandojmë që këto njolla t'i trajtoni përpara se të vendosni rrobat në pajisje.

Për këtë ka heqës të veçantë njollash. Përdorni heqës të veçantë njollash që i përshtaten llojit të njollës dhe pëlhurës.

Mos spërkatni heqës njollash mbi rrobat pranë pajisjes sepse është gërryes për pjesët plastike.



15.3 Lloji dhe sasia e detergjentit

Zgjedhja e detergjentit dhe përdorimi i sasive të duhura jo vetëm që ndikon te performanca në larje, por ndihmon gjithashtu edhe në shmangien e mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit:

- Përdorni vetëm detergjente dhe trajtime të tjera të prodhuara posaçërisht për lavatriçe. Së pari, ndiqni këto rregulla të përgjithshme:
  - detergjentet në trajtë pluhuri për të gjitha llojet e rrobave, duke përfshirë delikatet. Preferohen detergjente pluhur që përmbajnë zbardhues për higjienizimin e të bardhave dhe rrobave të palara,
  - detergjentet në trajtë lëngu, mundësisht për programe me temperatura të ulëta (60 °C maksimumi) për të gjitha llojet e rrobave ose të posaçme vetëm për të leshtat.
- Zgjedhja dhe sasia e detergjentit varen nga: lloji i tekstilit (delikate, të leshta, pambuk etj.), ngjyra e rrobave, madhësia e ngarkesës, niveli i ndotjes, temperatura e larjes dhe fortësia e ujit të përdorur.
- Ndiqni udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i detergjenteve ose trajtimeve të tjera pa tejkaluar nivelin e treguar maksimal (**MAX**).
- Mos i përzieni llojet e ndryshme të detergjenteve.
- Përdorni më pak detergjent, nëse:
  - po lani një sasi të vogël rrobash,
  - rrobat nuk janë shumë të ndotura,
  - formohet shumë shkumë gjatë larjes.
- Kur përdorni tableta ose bustina detergjenti, gjithmonë futini brenda në kazan, jo në folenë e detergjentit.

Detergjenti i pamjaftueshëm mund të shkaktojë:

- rezultate të pakënaqshme larjeje,
- ngarkesa e larjes bëhet gri,
- rroba me yndyrë,
- myk në pajisje.

Detergjenti i tepërt mund të shkaktojë:

- prodhim të tepërt shkume,
- efekt larjeje të reduktuar,
- shpëlarje të pamjaftueshme,
- ndikim më të madh në mjedis.

15.4 Këshilla ekologjike

Për të kursyer ujin, energjinë, si dhe për të ndihmuar në mbrojtjen e mjedisit, rekomandojmë të ndiqni këto këshilla:

- **Rrobat me ndotje normale**mund të lahen **pa paralarje** për të kursyer detergjent, ujë dhe kohë (duke mbrojtur gjithashtu dhe mjedisin!).
- Mbushja e pajisjes deri në **kapacitetin maksimal që tregohet për secilin prej programeve, ndihmon në reduktimin e energjisë dhe konsumit të ujit**.
- Me trajtim të përshtatshëm paraprak, mund të hiqen njollat dhe ndotja deri në një farë shkalle; rrobat pastaj mund të lahen në temperaturë më të ulët.
- Për të përdorur sasinë e duhur të detergjentit, shikoni sasinë e sugjeruar nga prodhuesi i detergjentit dhe kontrolloni fortësinë e ujit të sistemit tuaj shtëpiak. Shikoni paragrafin “Fortësia e ujit”.
- Caktoni **shpejtësinë maksimale të mundshme të centrifugimit** për programet e zgjedhura për kursimin e energjisë gjatë fazës së tharjes!

15.5 Fortësia e ujit

Nëse fortësia e ujit në zonën tuaj është e lartë ose mesatare, rekomandojmë që të përdorni zbutës uji për lavatriçe. Në zonat ku uji është i butë nuk nevojitet përdorimi i zbutësit të ujit.

Kontaktoni me autoritetet lokale të ujësjellësit për të mësuar fortësinë e ujit.

Përdorni sasinë e duhur të zbutësit të ujit. Zbatoni udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i produktit.

15.6 Përgatitja e ciklit të tharjes

- Hapeni rubinetin e ujit.
- Kontrolloni nëse tubi i shkarkimit është lidhur mirë. Shikoni kapitullin e instalimit për më shumë informacion.
- Për ngarkesë maksimale rrobash në programet e tharjes, shikoni tabelën e programeve të tharjes.

15.7 Artikuj të papërshtatshëm për tharje

Mos vendosni program tharjeje për këto rroba:

- Perde sintetike.
- Copa që kanë pjesë metali të bashkëngjitura.
- Çorape najloni.
- Kuverta.
- Mbulesa krevati.
- Jorganë.
- Xhupa me kapuç.
- Dyshekë gjumi.
- Coha me mbetje të llakut të flokëve, produkte për lyerjen e thonjve ose gjëra të ngjashme.
- Artikuj me sfungjer të gomuar ose materiale të ngjashme me të.

15.8 Etiketat e veshjeve

Kur thani rrobat, zbatoni udhëzimet në etiketat e prodhuesve:

- = Artikulli mund të thahet
- = Cikli i tharjes është në temperaturë të lartë
- = Cikli i tharjes është në temperaturë të reduktuar
- = Artikulli nuk mund të thahet.

15.9 Kohëzgjatja e ciklit të tharjes

Koha e tharjes mund të ndryshojë në varësi të:

- shpejtësisë së shtrydhjes përfundimtare
- nivelit të tharjes
- llojit të rrobave
- peshës së ngarkesës

15.10 Tharje shtesë

Nëse rrobat janë ende të njoma në përfundim të programit të tharjes, zgjidhni sërish një cikël të shkurtër tharjeje.

PARALAJMËRIM!
Për të shmangur rrudhat dhe hyrjen në ujë të rrobave, mos i lini ato të thahen më shumë sesa duhet.

15.11 Këshilla të përgjithshme

Shikoni tabelën "Programet e tharjes" për të gjetur kohën **mesatare** të tharjes. Përvoja do t'ju ndihmojë t'i thani rrobat më mirë. Mbani shënim kohëzgjatjen e cikleve që keni realizuar më parë.

Për të shmangur shkarkimin statik në përfundim të ciklit të tharjes:

1. Përdorni zbutës rrobash në ciklin e larjes.
2. Përdorni zbutës të veçantë për tharësit.

Kur programi i tharjes ka përfunduar, hiqni rrobat shpejt.

16. KUJDESI DHE PASTRIMI

PARALAJMËRIM!
Referojuni kapitujve për sigurinë.

16.1 Programi i pastrimit periodik

Pastrimi periodik ndihmon në zgjatjen e jetëgjatësisë së pajisjes.

Pas çdo cikli, mbajeni derën dhe folenë e detergjentit paksa të hapur që të ketë qarkullim të ajrit dhe që të thani lagështirën brenda pajisjes: kjo do të parandalojë mykun dhe aromat e këqija.

Nëse pajisja nuk do të përdoret për një kohë të gjatë: mbyllni rubinetin e ujit dhe shkëputni pajisjen nga rrjeti elektrik.

Programi tregues i pastrimit periodik:

Heqja e çmërsit	Dy herë në vit
Larja e mirëmbajtjes	Një herë në muaj
Pastrimi i guarnicionit të derës	Çdo dy muaj
Pastrimi i kazanit	Çdo dy muaj

Heqja e pushit brenda kazanit	Dy herë në muaj[1)]
Pastrimi i folesë së detergjentit	Çdo dy muaj
Pastrimi i filtrit të pompës së shkarkimit	Dy herë në vit
Pastrimi i tubit të hyrjes së ujit dhe filtrit të valvulës	Dy herë në vit

1) Shikoni kapitullin “Push në rroba”.

Paragrafët e mëposhtëm shpjegojnë se si duhet ta pastroni secilën pjesë.

16.2 Heqja e objekteve të huaja

Sigurohuni që xhepat të jenë bosh dhe të gjitha elementet e lira të jenë lidhur përpara se të vini në punë ciklin. Shikoni “Ngarkesa e rrobave” te “Udhëzime dhe këshilla”.

Hiqni çdo objekt të huaj (si p.sh. kapëse metalike, kopsa, monedha etj.) që mund të gjeni në guarnicionin e derës, filtra dhe kazan. Shikoni paragrafët “Guarnicioni i derës me filtër me buzë të dyfishtë”, “Pastrimi i kazanit”, “Pastrimi i pompës së shkarkimit” dhe “Pastrimi i tubit të hyrjes së ujit dhe filtrit të valvulës”. Nëse është e nevojshme, kontaktoni me Qendrën e Autorizuar të Shërbimit.

16.3 Pastrimi i jashtëm

Pastrojeni pajisjen vetëm me ujë të ngrohtë dhe sapun të butë. Thajini plotësisht të gjitha sipërfaqet. Mos përdorni shtupa kruajtëse ose materiale të tjera gërvishtëse.

KUJDES!
Mos përdorni alkool, tretës boje ose produkte kimike.

KUJDES!
Mos pastroni sipërfaqet metalike me detergjent me bazë klori.

16.4 Heqja e çmërsit

Nëse fortësia e ujit në zonën tuaj është e lartë ose mesatare, rekomandojmë që të përdorni produkt zbutjeje uji për lavatriçe.

Kontrollojeni kazanin rregullisht për të kontrolluar për çmërs.

Detergjentet standarde përmbajnë agjentë për zbutjen e ujit, por rekomandojmë që herë pas here të vini në punë një cikël me kazan bosh dhe një produkt kundër çmërsit.

Zbatoni gjithmonë udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i produktit.

16.5 Larja e mirëmbajtjes

Përdorimi i përsëritur dhe i zgjatur i programeve me temperaturë të ulët mund të shkaktojë depozitime të detergjenteve, mbetje pushi, rritje të bakterevе brenda kazanit. Kjo mund të krijojë aroma të këqija dhe myk. Për të eliminuar depozitimet dhe për të pastruar pjesën e brendshme të pajisjes, aplikoni një larje mirëmbajtjeje rregullisht (të paktën një herë në muaj).

Referojuni paragrafit "Pastrimi i kazanit".

16.6 Guarnicioni i derës me filtër me buzë të dyfishtë

Kjo pajisje është projektuar me **sistem shkarkues me vetëpastrim**, që i lejon fibrat e lehta të pushit që bien nga rrobat të shkarkohen jashtë bashkë me ujin. Inspektoni vazhdimisht izolimin. Monedhat, kopsat, objektet e tjera të vogla mund të mblidhen në përfundim të ciklit.



Pastrojeni kur nevojitet, duke përdorur agjent pastrues me krem amoniaku pa gërvishtur sipërfaqen e izolimit.

Zbatoni gjithmonë udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i produktit.

16.7 Pastrimi i kazanit

Kontrollojeni kazanin rregullisht për të parandaluar depozitimet e padëshiruara.

Në kazan mund të formohen grumbullime ndryshku si pasojë e ndryshkjes së trupave të huaj nga larja apo nga uji i rubinetit që përmban hekur

Pastroni kazanin me produkte speciale për çelik inoks.

Zbatoni gjithmonë udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i produktit.
Mos e pastroni kazanin me produkte acide për heqjen e çmërsit, produkte gërryese që përmbajnë klor ose hekur apo me lesh teli.

Për pastrim të plotë:

1. Nxirrni të gjitha rrobat nga kazani.
2. Vini në punë programin Pastrimi i pajisjes . Për më shumë detaje, referojuni tabelës së programeve të larjes.
3. Shtoni një sasi të vogël detergjenti pluhur në kazanin bosh, për të shpëlarë mbetjet që mund të mbetur.

Ndonjëherë, në përfundim të një cikli ekrani mund të shfaqë ikonën : Ky është rekomandim për të kryer një "pastrim të kazanit". Pasi të jetë kryer pastrimi i kazanit, ikona zhduket.

16.8 Pastrimi i sirtarit të detergjentit

Për të parandaluar depozitimet e mundshme të detergjenteve të thara apo zbutësit të rrobave dhe/ose formimin e mykut në sirtarin e detergjentit, herë pas here kryeni procedurën e mëposhtme të pastrimit:

1. Hapni sirtarin. Shtypni kapësen poshtë siç tregohet në figurë dhe tërhiqeni.



2. Hiqni pjesën e sipërme të folesë së aditivit për të ndihmuar pastrimin dhe për ta larë në ujë të rrjedhshëm të ngrohtë, për të hequr gjurmët e detergjentit të akumuluar. Pas pastrimit, vendoseni sërish pjesën e sipërme në vendin e vet.



3. Sigurohuni që të gjitha mbetjet e detergjentit të hiqen nga pjesa e sipërme dhe e poshtme e folesë. Përdorni një furçë të vogël për të pastruar folenë.



4. Futeni sirtarin e detergjentit në udhëzuesit e vet dhe mbylleni. Vini në punë një program shpëlarjeje pa rroba në kazan.



16.9 Pastrimi i pompës së shkarkimit

PARALAJMËRIM!
Shkëputni spinën nga priza elektrike.

Kontrolloni rregullisht filtrin e pompës së shkarkimit dhe sigurohuni që të jetë e pastër.

Pastrojeni pompën e shkarkimit nëse:
- Pajisja nuk e shkarkon ujin.
- Kazani nuk rrotullohet.
- Pajisja bën një zhurmë të pazakontë për shkak të bllokimit të pompës së shkarkimit.
- Në ekran shfaqet kodi i alarmit E20.

PARALAJMËRIM!
- Mos e hiqni filtrin gjatë kohës që pajisja është në punë.
- Mos e pastroni pompën nëse uji në pajisje është i nxehtë. Prisni derisa uji të ftohet

Vazhdoni si më poshtë për të pastruar pompën:



1. Hapni kapakun e pompës.



2. Vendosni një enë të përshtatshme poshtë pompës së shkarkimit për të mbledhur ujin që del prej aty.
Mbani gjithmonë një leckë pranë për të fshirë çdo rrjedhje uji gjatë heqjes së filtrit.



3. Rrotullojeni filtrin 180 gradë në drejtim të kundërt të akrepave të orës për ta hapur, pa e hequr. Lëreni ujin të dalë.
4. Kur ena të jetë mbushur plot me ujë, kthejeni filtrin në vend dhe boshatiseni enën.
5. Përsëritni hapat 3 dhe 4 derisa uji të ndalojë daljen.



6. Rrotullojeni filtrin në drejtim të kundërt të akrepave të orës për ta çmontuar



7. Nëse është e nevojshme, hiqni pushin dhe objektet nga foleja e filtrit.
Sigurohuni që helika e pompës të mund të rrotullohet. Nëse nuk rrotullohet, kontaktoni qendrën e autorizuar të shërbimit.



8. Pastroni filtrin poshtë rubinetit të ujit.



9. Vendoseni sërish filtrin në udhëzuesit e veçantë duke e rrotulluar në drejtim të akrepave të orës. Sigurohuni që filtri të jetë shtrënguar mirë për të shmangur rrjedhjet.



10. Mbyll kapakun e pompës.

Kur e shkarkoni ujin me procedurën e shkarkimit të emergjencës, ju duhet ta aktivizoni përsëri sistemin e shkarkimit:

1. Hidhni 2 litra ujë në folenë e larjes kryesore të folesë së detergjentit.
2. Nisni programin për të shkarkuar ujin.

16.10 Pastrimi i tubit të hyrjes së ujit dhe filtrit të valvulës









16.11 Shkarkimi i emergjencës

Nëse pajisja nuk mund ta shkarkojë ujin, kryeni të njëjtën procedurë që përshkruhet në paragrafin "Pastrimi i pompës së shkarkimit". Nëse është e nevojshme, pastroni pompën.

Kur e shkarkoni ujin me procedurën e shkarkimit të emergjencës, ju duhet ta aktivizoni përsëri sistemin e shkarkimit:

1. Hidhni 2 litra ujë në folenë e larjes kryesore të folesë së detergjentit.
2. Nisni programin për të shkarkuar ujin.

16.12 Masat paraprake të parandalimit të brymës

Nëse pajisja është e instaluar në një zonë ku temperatura mund të arrijë vlera rreth 0° C ose të bjerë më poshtë, hiqni ujin e mbetur nga tubi i hyrjes së ujit dhe pompa e shkarkimit.

1. Hiqni spinën nga priza elektrike.
2. Mbyllni rubinetin e ujit.
3. Vendosni dy skajet e tubit të hyrjes së ujit në një enë dhe lëreni ujin të rrjedhë nga tubi.
4. Zbrazni pompën e shkarkimit. Referojuni procedurës së shkarkimit të emergjencës.
5. Kur pompa e shkarkimit të jetë e zbrazur, vendosni përsëri tubin e hyrjes së ujit.

PARALAJMËRIM!
Sigurohuni që temperatura të jetë më e lartë se 0 °C përpara se ta përdorni sërish pajisjen.
Prodhuesi nuk mban përgjegjësi për dëme të shkaktuara nga temperaturat e ulëta.

17. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

PARALAJMËRIM!
Referojuni kapitujve për sigurinë.

17.1 Hapja e derës në rast emergjence

Në rast të shkëputjes së energjisë ose defekteve në funksionim, dera e pajisjes mbetet e kyçur. Programi i larjes vazhdon kur të rikthehet energjia. Nëse në rast defekti dera mbetet e kyçur, mund ta hapni atë duke përdorur funksionin e shkyçjes së emergjencës.

Përpara hapjes së derës:

KUJDES!
Ka rrezik djegieje!
Sigurohuni që temperatura e ujit nuk është tepër e lartë dhe rrobat të mos jenë të nxehta. Nëse nevojitet, prisni derisa të ftohen.

KUJDES!
Rrezik plagosjeje!
Sigurohuni që kazani të mos rrotullohet. Nëse nevojitet, prisni derisa kazani të ndalojë së rrotulluari.

Sigurohuni që niveli i ujit brenda në kazan të mos jetë shumë i lartë. Nëse nevojitet, kryeni zbrazjen e emergjencës (shikoni "Zbrazja e emergjencës" në kapitullin "Kujdesi dhe pastrimi").

Për të hapur derën, veproni si më poshtë:

1. Shtypni butonin e On/Off për të fikur pajisjen.
2. Shkëputni spinën nga priza elektrike.
3. Tërhiqni një herë poshtë këmbëzën e zhbllokimit të emergjencës. Tërhiqeni një herë sërish, mbajeni të tendosur dhe, ndërkohë, hapni derën e pajisjes. Aktivizuesi i zhbllokimit të emergjencës ndodhet aty ku tregohet nga figura e mëposhtme.



4. Nxirrni rrobat dhe pastaj mbyllni derën e pajisjes.

17.2 Kodet e alarmit dhe defektet e mundshme

Pajisja nuk ndizet ose ndalon gjatë punës. Së pari, përpiquni të gjeni një zgjidhje për problemin (shikoni tabelat).

PARALAJMËRIM!
Çaktivizojeni pajisjen përpara se të kryeni ndonjë kontroll.

Për disa probleme, ekrani tregon kodin e alarmit dhe butoni Start/Pause ▷|| **mund të pulsojë në mënyrë të vazhdueshme:**

Nëse pajisja është e mbingarkuar, hiqni disa artikuj nga kazani dhe/ose mbani shtypur derën ndërsa prekni butonin Start/Pause derisa treguesi ⊸0 të ndalojë së pulsuari (shikoni figurën më poshtë).



Problemi	Zgjidhja e mundshme
E 10 Pajisja nuk mbushet mirë me ujë.	• Sigurohuni që rubineti i ujit të jetë i hapur. • Sigurohuni që presioni i furnizimit me ujë të mos jetë shumë i ulët. Për këtë informacion, kontaktoni autoritetet vendase të ujësjellësit. • Sigurohuni që rubineti i ujit të mos jetë i bllokuar. • Sigurohuni që zorra e furnizimit me ujë të mos jetë e përdredhur, e dëmtuar ose e përthyer. • Sigurohuni që lidhja e zorrës së hyrjes së ujit të jetë e saktë. • Sigurohuni që filtri në zorrën hyrëse dhe filtri i valvulës të mos jenë të bllokuar. Shikoni kapitullin “Kujdesi dhe pastrimi”.
E20 Pajisja nuk e shkarkon ujin.	• Sigurohuni që tubi lidhës i lavamanit të mos jetë i bllokuar. • Sigurohuni që zorra e shkarkimit të mos jetë e përdredhur ose e përthyer. • Sigurohuni që filtri i shkarkimit të mos jetë i bllokuar. Nëse është e nevojshme, pastrojeni filtrin. Shikoni kapitullin “Kujdesi dhe pastrimi”. • Sigurohuni që lidhja e zorrës së shkarkimit të jetë e saktë. • Vendosni programin e shkarkimit nëse vendosni programin pa fazën e shkarkimit. • Vendosni programin e shkarkimit nëse vendosni një opsion që përfundon me ujë në kazan.
E40 Dera e pajisjes është e hapur ose nuk është mbyllur mirë.	• Sigurohuni që dera të jetë mbyllur mirë.

E91 Avari e brendshme. Nuk ka komunikim ndërmjet elementëve elektronikë të pajisjes.	• Programi nuk ka përfunduar siç duhet ose pajisja ka ndaluar shumë herët. Fikeni dhe rindizeni pajisjen. • Nëse shfaqet sërish kodi i alarmit, kontaktoni qendrën e autorizuar të shërbimit.
EH0 Furnizimi me rrymë është i paqëndrueshëm.	• Prisni derisa furnizimi me rrymë të bëhet i qëndrueshëm.
EF0 Është aktivizuar pajisja kundër përmbytjes.	• Shkëputni pajisjen dhe mbyllni rubinetin e ujit. Kontaktoni qendrën e autorizuar të shërbimit.

Nëse ekrani shfaq kode të tjera alarmi, çaktivizoni dhe aktivizoni pajisjen. Nëse problemi vazhdon, lidhuni me qendrën e autorizuar të shërbimit.
Në rast problemi të ndryshëm me lavatriçen, kontrolloni tabelën e mëposhtme për zgjidhjet e mundshme.

Problemi	**Zgjidhja e mundshme**
Programi nuk fillon.	• Sigurohuni që spina të jetë futur në prizë. • Sigurohuni që dera e pajisjes të jetë e mbyllur. • Sigurohuni që kutia e siguresave të mos ketë ndonjë siguresë të prishur. • Sigurohuni që Start/Pause ▷‖ të jetë prekur. • Nëse caktohet vonesa në nisje e programit, anulojeni cilësimin ose prisni sa të përfundojë numërimi mbrapsht. • Çaktivizoni funksionin e bllokimit për fëmijët, nëse është i ndezur. • Kontrolloni pozicionin e çelësit në programin e përzgjedhur.
Pajisja mbushet me ujë dhe e shkarkon atë menjëherë.	• Sigurohuni që zorra e shkarkimit të jetë në pozicionin e duhur. Zorra mund të jetë pozicionuar shumë poshtë. Shihni kapitullin “Udhëzime instalimi”.
Faza e centrifugimit nuk funksionon ose cikli i larjes zgjat më shumë se zakonisht.	• Vendosni programin e centrifugimit. • Sigurohuni që filtri i shkarkimit të mos jetë i bllokuar. Nëse është e nevojshme, pastrojeni filtrin. Shikoni kapitullin “Kujdesi dhe pastrimi”. • Rregulloni me dorë artikujt brenda kazanit dhe niseni sërish fazën e centrifugimit. Ky problem mund të shkaktohet nga probleme ekuilibri.

Problemi	Zgjidhja e mundshme
Ka rrjedhur ujë në dysheme.	• Sigurohuni që bashkueset e zorrëve të ujit të jenë shtrënguar fort dhe që nuk ka rrjedhje uji. • Sigurohuni që zorra e hyrjes së ujit dhe zorra e shkarkimit të mos kenë dëmtime. • Sigurohuni që të përdorni detergjentin e duhur dhe sasinë e duhur të tij.
Dera e pajisjes nuk mund të hapet.	• Sigurohuni që të mos jetë zgjedhur një program larjeje që përfundon me ujë në kazan. • Sigurohuni që programi i larjes ka përfunduar. • Vendosni programin e shkarkimit ose të centrifugimit nëse ka ende ujë në kazan. • Sigurohuni që pajisja furnizohet me energji. • Ky problem mund të shkaktohet nga një defekt i pajisjes. Kontaktoni qendrën e autorizuar të shërbimit. Nëse ju duhet të hapni derën, ju lutemi të lexoni me kujdes “Hapja e derës në rast emergjence”.
Pajisja bën një zhurmë të pazakontë dhe dridhet.	• Sigurohuni që nivelimi i pajisjes është i saktë. Shihni kapitullin “Udhëzime instalimi”. • Sigurohuni që të keni hequr paketimin dhe/ose bulonat e transportit. Shihni kapitullin “Udhëzime instalimi”. • Shtoni më shumë rroba në kazan. Ngarkesa mund të jetë tepër e vogël.
Kohëzgjatja e programit ngrihet ose ulet gjatë punës së programit.	• ProSense System është në gjendje të përshtatë kohëzgjatjen e programit sipas llojit dhe sasisë së rrobave. Shikoni paragrafin “Dallimi i ngarkesës me ProSense System“ në kapitullin “Përdorimi i përditshëm”.
Rezultatet e larjes nuk janë të kënaqshme.	• Shtoni sasinë e detergjentit ose përdorni një lloj tjetër. • Përdorni produkte të veçanta për të hequr njollat e vështira përpara se të lani rrobat. • Sigurohuni që të vendosni temperaturën e duhur. • Pakësoni ngarkesën e rrobave.
Ka shumë shkumë në kazan gjatë ciklit të larjes.	• Reduktoni sasinë e detergjentit.
Pas ciklit të larjes, ka ende mbetje detergjenti në sirtarin e detergjentit.	• Sigurohuni që fleta të jetë në pozicionin e duhur (LART për detergjent pluhur - POSHTË për detergjent të lëngshëm). • Sigurohuni që ta përdorni folenë e detergjentit sipas këshillave që jepen në këtë manual përdorimi.
Pajisja nuk than ose nuk than siç duhet.	• Hapni rubinetin e ujit. • Sigurohuni që filtri i shkarkimit të mos jetë i bllokuar. • Pakësoni ngarkesën e rrobave. • Sigurohuni që të keni vendosur ciklin e saktë. Nëse nevojitet, vendosni sërish një kohë tharjeje të shkurtër.

Problemi	Zgjidhja e mundshme
Rrobat janë plot me push me ngjyra të tjera.	Rrobat e lara në ciklin e mëparshëm, kanë lëshuar push të një ngjyre tjetër: • Faza e tharjes ndihmon në eliminimin e një pjese të pushit. • Pastroni rrobat me një heqës pushi. Në rast se ka sasi të tepruar pushi në kazan, aktivizoni një program të veçantë për ta pastruar atë (shikoni “Push në rroba” për hollësi të mëtejshme).

Pas kontrollit, aktivizojeni pajisjen. Programi vazhdon nga pika e ndërprerjes.
Nëse problemi ndodh përsëri, lidhuni me qendrën e autorizuar të shërbimit.
Të dhënat e nevojshme për qendrën e shërbimit ndodhen në etiketën e parametrave.

18. VLERAT E KONSUMIT

18.1 Hyrje

Ky manual tregon dy tabela të ndryshme për të favorizuar kalimin gradual nga një rregullore në tjetrën:
- Direktiva 96/60/EC, e vlefshme deri në 28 shkurt 2021, lidhet me etiketën e energjisë që raporton klaset e efikasitetit energjetik nga **A** në **G** për ciklet e larjes dhe tharjes.
- Rregullorja 2019/2023 e Komisionit të BE-së, e vlefshme nga data 1 mars 2021, lidhet me etiketën e energjisë që raporton klaset e efikasitetit energjetik, si shkallë e dyfishtë nga **A** në **G**, për ciklin e plotë të larjes dhe tharjes dhe për ciklin vetëm larje, siç përcaktohet nga Rregullorja e BE-së 2019/2014.

Shikoni lidhjen **www.theenergylabel.eu** për informacion të detajuar rreth etiketës së energjisë.

Kodi QR në etiketën e energjisë të dhënë me pajisjen jep një lidhje uebi te informacioni që lidhet me performancën e pajisjes në databazën e EU EPREL. Ruajeni etiketën e energjisë për referencë së bashku me manualin e përdorimit dhe të gjitha dokumentet e tjera që ofrohen me këtë pajisje.
Të njëjtin informacion mund ta gjeni gjithashtu në EPREL duke përdorur lidhjen **https://eprel.ec.europa.eu** dhe emrin e modelit dhe numrin e produktit që gjeni në pllakëzën e specifikimeve të pajisjes. Shikoni kapitullin “Përshkrim i produktit” për pozicionin e pllakëzës së specifikimeve.

18.2 Legjenda

kg	Ngarkesa e pajisjes.	**o:mm**	Kohëzgjatja e programit.
kWh	Konsumi i energjisë.	**°C**	Temperatura në rroba.

Litra	Konsumi i ujit.	**rpm**	Shpejtësia e centrifugimit.
%	Lagështira e mbetur në fund të ciklit. Sa më e lartë të jetë shpejtësia e centrifugimit, aq më e lartë është zhurma dhe aq më e ulët është lagështia e mbetur në fund të ciklit të larjes.		

Vlerat dhe kohëzgjatja e programit mund të variojnë në varësi të kushteve të ndryshme (p.sh. temperatura e dhomës, temperatura e ujit dhe presioni, madhësia e ngarkesës dhe lloji i rrobave, tensioni i furnizimit) dhe gjithashtu nëse ndryshoni cilësimin e parazgjedhur të një programi.

18.3 Sipas Rregullores së Komisionit të BE-së 2019/2023

Vetëm larje

Eco 40-60 Programi	**kg**	**kWh**	**Litra**	**o:mm**	**%**	**°C**	**rpm**[1)]
Ngarkesë e plotë	8	1.085	60	3:30	50	46	1551
Gjysmë-ngarkesë	4	0.675	45	2:40	50	40	1551
Çerek ngarkesë	2	0.375	35	2:40	54	33	1551

1) Shpejtësia maksimale e centrifugimit.

Cikli i larjes dhe tharjes

Eco 40-60 Programi dhe niveli i tharjes për dollap	**kg**	**kWh**	**Litra**	**o:mm**	**%**	**°C**	**rpm**[1)]
Ngarkesë e plotë	4	3.215	68	6:15	0	41	1551
Gjysmë-ngarkesë	2	1.825	48	4:35	0	37	1551

1) Shpejtësia maksimale e centrifugimit.

Konsumi i energjisë në regjime të ndryshme

Fikur (W)	**Në gatishmëri (W)**	**Shtyrja e programit (W)**
0,30	0,30	4,00
Koha deri në fikje/Regjimi në pritje është maksimumi 15 minuta.		

18.4 Në përputhje me Direktivës 96/60/EC

Programi me kursim energjie për të pambukta	Ngarkesa (kg)	Konsumi i energjisë (kWh)	Konsumi i ujit (litra)	Kohëzgjatja e përafërt e programit (minuta)
Eco 40-60 në 60 °C	8	0.97	56	285

18.5 Programet e zakonshme - Vetëm larje

Këto vlera janë vetëm për qëllim informativ.

Programi	kg	kWh	Litra	o:mm	%	°C	rpm[1)]
Pambuk[2)] 90°C	8	1.75	85	3:45	44	85	1600
Pambuk 60°C	8	0.75	80	3:30	44	55	1600
Pambuk[3)] 20°C	8	0.25	80	2:50	44	20	1600
Sintetike 40°C	3	0.65	75	2:20	35	40	1200
Delikat[4)] 30°C	2	0.30	50	00:50	35	30	1200
Të leshta 30°C	1,5	0.25	60	1:05	30	30	1200

1) Treguesi i referencës së shpejtësisë së centrifugimit.

2) E përshtatshme vetëm për larjen e tekstileve me ndotje të madhe.

3) E përshtatshme për larjen e të pambuktave me ndotje të vogël.

4) Gjithashtu vepron si cikël i larjes së shpejtë për rrobat e ndotura pak.

18.6 Programet e zakonshme - Larje dhe tharje

Këto vlera janë vetëm për qëllim informativ.

Programi	kg	kWh	Litra	o:mm	%	°C	rpm[1)]
Sintetike 40°C	3	2.0	75	4:00	1	40	1200

1) Treguesi i referencës së shpejtësisë së centrifugimit.

19. ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AMBIENTIN

Ricikloni materialet me simbolin . Vendoseni ambalazhin te kontejnerët e riciklimit nëse ka. Ndihmoni në mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve dhe në riciklimin e mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike. Mos hidhni pajisjet e shënuara me simbolin e mbeturinave shtëpiake. Ktheni produktin në pikën lokale të riciklimit ose kontaktoni me zyrën komunale.

www.aeg.com/shop

157022401-A-252020

CE

AEG